



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Teknika Digjitale Dentare”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia Ivodent”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Ramazan Isufi

2. Dr. Alba Koshovari

Korrik 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia Ivodent”

1	IAL aplikues:	Akademia Ivodent
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Protetikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional “Teknika Digjitale Dentare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr.349, Datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Program i ri
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Akademia Ivoclar, Akademia 3Shape, Universiteti Politeknik i Tiranës
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Master Profesional me Akademia Ivoclar, Akademia 3Shape, Universiteti Politeknik i Tiranës
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8 PAE / 5 PAK
18	Numri i studentëve:	14
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM


Programi Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare” ofrohet nga Departamenti i Protetikës, Fakultetit të Teknikëve Dentare, Akademia Ivodont.

Ky program është hapur më 17/09/2021, me Urdhër Nr.349 nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky program i nënshtrohet procesit të akreditimit për herë të parë.

Programi i mësipërm ofron njohuri të thelluara profesionale kryesisht për Teknikët Dentarë, pa përjashtuar edhe Mjekët Stomatologë, të cilët merren me realizimin e protezave dentare dhe aparateve ortodontike, jo vetëm në laborator, por edhe në klinika dentare.

Fokusi i këtij programi është të aftësojë studentët në përdorimin e softë are-ve 3Shape dhe Exocad për dizenjimin e protezave dentare, aparateve ortodontike si dhe skanimin intraoral apo laboratorik, frezimin dhe printimin e protezave dentare nëpërmjet teknologjisë digjitale. Studentët marrin njohuri dhe praktikojnë shtresësizimin e materialeve qeramike, duke patur si qëllim estetikën maksimale në restaurimet dentare. Studentët, pasi përfundojnë këtë master, janë të aftë të prodhojnë proteza dentare totale, të pjesshme, fikse, të lëvizshme dhe të kombinuara, provizore apo të përhershme, si dhe implantoproteza.

Gjithashtu, studentët përgatiten mbi përdorimin e sistemit Cad-Cam, duke marrë njohuri të inxhinierisë mekatronike e robotike. Kjo falë edhe bashkëpunimit me Universitetin Politeknik të Tiranës.




PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm u realizua në përputhje me procedurat e vendosura nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Shqipërisë (ASCAL), dhe bazuar në kodin e cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me VKM Nr.824, Datë 24.12.2021.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u krijua nga ASCAL dhe përbëhet nga Prof. Dr. Ramazan Isufi, Dr. Alba Koshovari dhe përfaqësuesja e ASCAL, znj. Endra Velaj.

Grupi i vlerësimit të jashtëm u koordinua nga ekspertja e ASCAL, e cila i vuri në dispozicion materiale udhëzuese, funksionimin e grupit, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të grupit, u fokusua në standartet e kërkuara për vlerësimin si dhe dokumentat bazë për kryerjen e tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm do të japë një tablo gjithëpërfshirëse për Programin e Studimit Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare” duke u përqëndruar në avantazhet, si dhe mangësitë, me qëllim që të përmirësohen në të ardhmen.

Mbështetur në udhëzimet e ASCAL, grupi GVJ hartoi një plan pune për të marrë informacionet e nevojshme, si dhe afatet për realizimin e tij. GVJ, duke u ndihmuar nga stafi mbështetës i institucionit, organizoi takimet sipas programit të përcaktuar duke grumbulluar materialet e nevojshme, të cilat janë të paraqitura në raportin e mëposhtëm, kryesisht të vitit akademik 2021-2022. GVJ është përpjekur të bëjë një vlerësim dinamik të të gjitha çështjeve të paraqitura më poshtë, duke u bazuar në synimin që institucioni të rrisë cilësinë dhe performancën për këtë program në të ardhmen.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT


Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare”, i ofruar nga Departamenti i Protetikës së Akademisë Ivodent nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe është në përputhje të plotë me misionin e AI, i cili synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe përgatitjen e specialistëve në fushën e teknikave dentare analoge dhe digjitale, në përputhje me standartet Europiane. Programi synonte kualifikimin dhe rritjen profesionale studentëve në fushën e teknikave digjitale, njohjen me sistemin Cad-Cam, materialet moderne dentare, gjë që sillte edhe përmirësimin e cilësisë së nivelit shëndetësor të pacientit. Këto të dhëna GVJ i verifikoi gjatë vizitës në IAL dhe plotësonin standartet, si dhe ishin bashkëkohore për këtë program studimi. (A1, A5, A2, A2.1, A3, A4)
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Nga vlerësimi i GVJ, mund të konfirmohet se programi i studimit është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe Statutit të AI, në të cilin theksohet se misioni i institucionit është “ofrimi i programeve të studimit me karakter profesional në fushën e shëndetit dentar dhe teknikave e shkencës së materialeve të lidhura me të”. Vlen të përmendet edhe raporti teori-praktikë, në favor të praktikës së zhvilluar brenda ambienteve të institucionit dhe në laboratorë dentare, në formën e praktikave profesionale. Masteri Profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’, i cili akreditohet për herë të parë, ishte në trajtën e programeve të tjera si “Bachelori në Teknikë e Lartë Dentare”. (A1, A2, A3)



<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Duke u bazuar edhe në kërkesat e tregut vendas edhe në kërkesat e vendeve të huaja për specialistë në fushën e teknologjive digjitale dentare, GVJ mendon se hapja e Programit Master Profesional “Teknika Digjitale Dentare” krijonte mundësinë e zhvillimit arsimor shkencor dhe profesional të mjekëve stomatologe si dhe të specialistëve të teknikave dentare, duke përbushur një mungesë të tregut vendas dhe një kërkesë të tregut huaj. Pajisja e këtyre specialistëve me teknologjitë bashkëkohore u mundësonte atyre njohuritë e duhura dhe kualifikimin e mëtëjshëm në programet e ciklit të dytë që këto studentë mund të vazhdonin në të ardhmen. Ky program mendojmë se nxit zhvillimin lokal, kombëtar duke plotësuar gjithnjë e më shumë nevojat e tregut të punës për të përmirësuar nivelin e shëndetit oral të popullsisë si dhe aftësimin e këtyre specialistëve për të konkuruar në tregun vendas dhe të huaj. (A2, A3, B1, B2)</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Konsideruar stadin aktual të vendit tonë dhe të transformimit të tij drejt sfidave të BE, si përsa i përket arsimit, shëndetësisë dhe zhvillimit ekonomik, GVJ gjykon se hapja e këtij programi, me një staf akademik dhe specialistë të fushës, i cili bashkëpunon me institucionet vendase dhe të huaja, si dhe duke patur parasysh suportin e bizneseve, mendojmë se do të përgatisë teknikë dentare të aftë për plotësimin e nevojave të tregut të punës. (A6, A6.1, A6.2, A6.3, A6.4, A6.5, A6.6, B2, B3, B4, B5, B6)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Akademia Ivodent ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare, por synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike, kulturore dhe kombëtare. Ky program është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, duke u përshtatur me statutin dhe rregulloren e tij. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Akademia Ivodent është hapur për herë të parë në vitin 2003, duke përgatitur teknikë dentare, të cilët ishin shumë të nevojshëm në atë periudhë, pasi nuk kishte akoma një program të tillë studimi pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare. Që prej 2003 ky institucion kishte mbushur afërsisht dy dekada, duke përditësuar formimin e teknikëve dentare, duke u orientuar nga kërkesat bashkëkohore të mësimdhënies, infrastrukturës, burimeve njerëzore dhe sipas standarteve europiane të cilësisë. Duke parë infrastrukturën e këtij institucioni, mendojmë se ky dispononte kapacitetet e nevojshme logjistike dhe didaktike për realizimin me sukses të programit të studimit Master Profesional në “Teknika Digjitale Dentare”. Ndër to përmendim sallat e leksioneve, të seminareve, biblioteka dhe laboratorët përkatës, të cilët ne i verifikuam gjatë vizitës në IAL. Duke patur parasysh vite të ndryshme akademike, veçanërisht 2021 – 2022, ne pamë të angazhuar një personel akademik prej 9 personash, nga të cilët 5 me kohë të plotë dhe 4 me kohë të pjesëshme. Për realizimin e këtij programi një suport i rëndësishëm ishte bashkëpunimi i këtij institucioni me kompanitë Ivoclar – Vivadent AG (Liechtestein), BEGO GMBH (Gjermani), Rhein 83 (Itali), Renfert GMBH (Gjermani), etj. Këto kompani kishin një kontribut të rëndësishëm si në mësimdhënie, pajisje, materiale didaktike, teknologji moderne, dhe materiale bashkëkohore, pa nënvlerësuar trajnimet e vazhdueshme të stafit dhe studentëve të Akademisë. (A1, A7, A8, B7, B8, B9)</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Masteri Profesional në ‘Teknika digjitale Dentare’ ishte i fokusuar në përgatitjen dhe kualifikimin e studentëve lidhur me aparaturat digjitale Cad-Cam, njohjen e materialeve dentare si dhe përgatitjen e protezave dentare. Mësimdhënia, dhe kërkimi shkencor në Fakultetin e Teknikave Dentare përfshinte përveç këtyre tematikave edhe njohuri dhe përgatitje mbi ortodonci dhe implantoproteze, degë në të cilat teknikat digjitale marrin një rëndësi të lartë dhe aplikim. Këto fusha ishin në përputhje me programin e studimit, i cili përfshinte arsimimin dhe kualifikimin personal të studentëve.</p>


<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Fusha e programit MP në TDD ishte në përputhje me fushën akademike kërkimore të departamentit të protetikës dhe implantoprotezës së Akademisë Ivodent (A.1 A.10 A.11). Programi i studimit Master Profesional në ‘Teknika digjitale Dentare’ kodifikohej sipas International Standart Classification of Education (ISCED) në nivelin 7 Health and Welfare 72 (A.9). Programi i studimit Master Profesional në ‘Teknika digjitale Dentare’ klasifikohej, sipas kornizës së kualifikimeve shqiptare, si një kualifikim i nivelit 7 dhe kodifikohej me numrin 1032. Aktualisht në këtë akademi nuk pamë të ofroreshin programe studimi ndërdisiplinor.</p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Master Profesional në ‘Teknika digjitale Dentare’ nuk ofrohej në formën e studimit ndërdisiplinor dhe aplikohet krejtësisht brenda profilit të Akademisë Ivodent.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Akademia Ivodent kishte bashkëpunime me institucione të tjera të Arsimit të Lartë, me të cilat kishte lidhur marrëveshje. AI (akademia Ivodent) kishte marrëveshje me laboratorë dentare në Shqipëri, në bashkëpunim me të cilë ofronte trajnime profesionale. AI ishte në bashkëpunim të vazhdueshëm edhe me qendra europiane si Akademia Ivoclar dhe Akademia 3Shape, përmes të cilave garantonte edukimin e vazhdueshëm profesional, nëpërmjet trajnimeve dhe aktiviteteve që certifikoheshin dhe vlerësoheshin me kredite nga QKEV (A.13, A14). Institucioni gjithashtu kishte organizuar konferenca dhe mundësi trajnimi për studentët aktuale dhe ata të diplomuar. Këto të dhëna u verifikuan sipas të dhënave të mëposhtme. (A12 B10 A6 A6.1 A6.2 A6.3 A6.4 A6.5 A6.6).</p>			
	<p><i>Institucioni ka kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e këtij programi sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe europiane, gjë që garantohet edhe nga bashkëpunimi me institucionet partnere.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>



Standardi I.3


Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Për sa i përket programeve të studimit në Fakultetin e Teknikave Dentare, ato synonin një nivel të krahasueshëm me diplomat e fakulteteve jashtë vendit, por këto programe të reja studimi ishin hartuar në përshtatje me nevojat e shoqërisë shqiptare, kushtet aktuale dhe perspektivat e zhvillimit të vendit tonë. Personeli akademik përfshinte lektorë vendas dhe të huaj. Programi i studimit ishte hartuar nëpërmjet ngritjes së një grupi pune nga personel akademik i Departamentit të Protetikës dhe Dekani. Programi i studimit i diskutuar dhe përcaktuar në Departament dhe Dekanat, ishte miratuar në Senat Akademi, i cili më pas e kishte dërguar për miratim tek Bordi i Administrimit (A3 A10 A11).</p> <p>Cdo vit institucioni realizonte matjen e Cilësisë në Arsimin e Lartë, bazuar në treguesit e standarteve shtetërore. Kjo bëhej nëpërmjet vlerësimit të ecures së programeve të studimit, duke verifikuar apo modifikuar kurrikulat, planet mësimore dhe modulet e ndryshme. Kurrikulat, nëse vendosej të modifikoheshin, rishikoheshin dhe ndryshoheshin në përputhje me përqindjet e lejuara. AI ishte një institucion i vogël, ndaj funksionimi, bashkëpunimi dhe përgjegjësitë përkatëse menaxhoheshin në mënyrë të thjeshtë dhe adekuate. Cdo njësi hartonte raportin respektiv, i cili më pas përfshihej në analizën vjetore të institucionit. Kjo analizë, e cila më pas dërgohej në MAS, synonte evidentimin e arritjeve dhe problematikave me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të ecures së studimit dhe procesit mësimor në tërësi (A15 A16 A17 A18).</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>Akademia Ivodent kishte marrëdhënie të vazhdueshme bashkëpunimi me një numër institucionesh brenda dhe jashtë vendit. Kjo ofronte mundësinë e shkëmbimit të dijeve, duke synuar të nxisëmësimdhënien dhe mësimnxënien. (A6 A6.1 A6.2 A6.3 A6.4 A6.5 A6.6). Konsideruar bashkëpunime e suksesshme aktuale, AI synonte të rriste përpjekjet për bashkëpunime të reja me institucione brenda dhe jashtë vendit.</p>



<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Akademia Ivodent kishte marrëveshje bashkëpunimi me rreth 15 laboratorë dhe klinika dentare brenda vendit me të cilët kishte akses për realizimin e praktikave profesionale (B12). AI bashkëpunonte gjithashtu me qendra europiane si Akademia Ivoclar dhe Akademia 3Shape, dhe institucione të tjera vendase. Këto marrëveshje i kishin dhënë akses studentëve për të qënë pjesë e konferencave të ndryshme apo programeve të mobilitetit, si dhe realizimin e praktikave profesionale (A6 A6.1 A6.2 A6.3 A6.4 A6.5 A6.6 A12 A19). AI synonte në vazhdim për të realizuar marrëveshje të reja në kuadër të Erasmus Plus me universitetin e Shkupit - Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Universitetin Politeknik të Gdansk Poloni. Në këtë mënyrë do të bëhej e mundur aplikimi i mobilitetit të personelit Akademik dhe studentëve në kuadër të Erasmus plus (A21).</p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Marrdheniet e bashkëpunimit me institucionet vendase e të huaja, aplikimi i mobiliteti për personelin akademik dhe studentor diskutoheshin dhe miratoheshin në mbledhjet e Departamentit të Protetikës i cili ishte i angazhuar për krijimin e marrëveshjeve të reja. (A6, A22)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni funksionon dhe siguron marrëdhënie të mira bashkëpunimi brenda tij, duke ndarë detyrat e personelit, duke marrë në vazhdimësi përgjegjësitë përkatëse, si dhe duke bërë një analizë të vazhdueshme të punës së tyre. Institucioni ka gjithashtu marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit apo aktorët e biznesit.</i></p> <p><i>Institucioni synonte bashkëpunimin me institucione universitare europiane në kuadër të mobiliteti të Erasmus Plus, për të cilat po bëheshin përpjekje të mëdha por të cilat akoma nuk ishin realizuar. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>


<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X




II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi Master Profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ bazohej në rregulloren e Fakultetit të Teknikave Dentare dhe ishte në përputhje me misionin e AI, dhe përmbushte detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë (B1, A10). Programi ishte organizuar në module, lëndët ishin kategorizuar në bazë të veprimtarisë formuese, duke i ndarë ato në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Programi fokusohet kryesisht ti jepte rëndësi lëndëve praktike. Kreditet ECTS ndaheshin sipas kategorizimit të lëndëve, ku numrin më të lartë të krediteve e kishin lëndët karakterizuese dhe praktike, si përgatitja digjitale e kurorave dhe urave dentare, ndërsa numrin më të vogël e kishin lëndët bazë e ndërdisiplinore, të cilat kishin pjesën më të vogël të krediteve.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ ishte i fokusuar në objektivat për formimin teorik dhe praktik të studentëve dhe formimin e tyre profesional. Ky program ishte hartuar duke u bazuar në kërkesat dhe nevojat e tregut vendas të punës në aplikimin e teknikave digjitale. Në këtë mënyrë studentët e diplomuar mund të ngrinin klinika apo laboratore, ose të punësoheshin në të tilla, me siguri të larta profesionale. Njohuritë që studentët merrnin ishin të fushave të ndryshme, që nga komunikimi akademik, menaxhimi, përdorimi kompjuterik, anglishtja profesionale, llojet e materialeve, teknikat digjitale dhe praktika e protezimit dentar (B13). Ky program fokusohet në kualifikimin profesional dhe shkencor në fushën e teknikave digjitale në fushën e protezave dentare, aparateve ortodontike, si dhe implantoprotezë. Shpërndarja e orëve mësimore ishte organizuar me shumë në favor të praktikës se sa teorisë, e pasqyruar kjo edhe në ndarjen e krediteve ECTS të lëndëve. Studentët ishin kryesisht teknikë dentarë, por një pjesë e madhe e tyre ishin edhe mjekë stomatologë.</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi ishte organizuar sipas sistemit europian të transferimit dhe grumbullimit të kreditive (ECTS). Ky program realizohej në 1 vit studimi dhe ishte i ndarë në dy semestra, me 60 kredite ECTS në total. Programi i studimit Master Profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ plotësonte kërkesat dhe elementet e kërkuara nga ligji dhe aktet në nligjore. Ambjentet e leksioneve dhe laboratorët ishin të plotësuar me aparatura, softwere dhe instrumenta moderne dhe bashkëkohore. Programi përmbante 12 lëndë (48 kredite ECTS) dhe provimi përfundimtar 12 kredite ECTS. Praktikrat profesionale nuk ishin të përfshira brenda programit por programi realizonte një ndërthurje të koncepteve teorike dhe praktike në ambjentet e laboratoreve dentare të protetikës. Studentëve cdo 3 jave u kërkohej të realizonin punime komplekse dhe të paraqiteshin para komisionit vlerësues të pedagogëve të akademisë, duke realizuar në këtë mënyre kontrollin periodik të dijeve. Studenti diplomohet vetëm kur ishin shlyer të gjitha detyrimet akademike dhe diploma shoqërohej edhe me suplementin e diplomës.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Në Akademinë Ivodent nuk ofroheshin programe studimi të ciklit të dytë “Master në Mësuesi”.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të kreditive në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Në Akademinë Ivodent nuk ofroheshin programe studimi të ciklit të dytë “Master në Mësuesi”.</p>




<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Akademia Ivodent nuk kishte status të veçantë për sa i përket financimit, funksionimit apo organizimit të saj. AI kishte nënshkruar me Ministrinë e Arsimit një marrëveshje për marrjen në konsideratë të specifikës të një institucioni relativisht të vogël për sa i përket përmbushjes së detyrimeve për stafin akademik me kohë të plotë (A23).</p>			
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Akademia Ivodent ofronte aktualisht vetëm një program studimi të ciklit të dytë Master. Ky institucion kishte aplikuar për hapjen e një programi të dytë Master Shkëncor. Duke qënë se programi ishte unik në vendin tone, hartimi i tij ishte i bazuar në praktikatat ndërkombetare (B14).</p>			
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Duke qënë se programi Master Profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ ishte në proces akreditimi për herë të parë, ky program si dhe tre programet ekzistuese të studimit ishin akoma në faze të kodifikimit. Në këtë mënyrë do të realizohej edhe kodifikimi i lëndëve të programeve të studimit.</p>			
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Në Akademinë Ivodent aktualisht nuk ofroheshin programe të përbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Strukturat e programit të studimit vlerësuar në kredite janë përcaktuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe sistemin evropian të transferimit dhe grumbullimit të krediteve (ECTS). Ky program përvetëson teorinë dhe parimet akademike të fushës të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në aplikimin e tyre praktik. Duke qënë se vetë programi, si dhe lëndë te programit të studimit nuk kishin përfunduar akoma kodifikimin e tyre, GVV mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	




Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Fakulteti përbëhet nga dy departamente dhe një qendër kërkimore. Programi Master Profesional në 'Teknika Digjitale Dentare' ofrohet nga Fakulteti i Teknikave Dentare dhe zhvillimi i këtij programi ishte në përgjegjësinë e Departamentit të Protetikës. Institucioni në departamentet e tij kishte të aktivizuar personel akademik me kohë të plotë dhe të pjeshme duke garantuar cilësi në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Institucioni plotësonte detyrimet ligjore për të patur 7 pedagoge efektive personel të brendshëm për çdo njësi bazë, 3 prej të cilëve ishin me grada dhe tituj. 71% e ngarkesës mësimore mbulohej nga personeli akademik me kohë të plotë ndërsa 29% nga ata me kohë të pjeseshme. Në departamentin e Protetikës, i cili ofronte programin e studimit në fjalë, ishte i aktivizuar një personel me gradë Doktor dhe 3 personel akademik efektiv(A24).</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Personeli ndihmës akademik ishte i trajnuar dhe kualifikuar edhe nga bashkëpunëtorë të huaj të institucionit, si Akademia Ivoclar dhe ajo 3Shape, dhe ishte i angazhuar në mbarëvajtjen dhe organizimin e orëve mësimore. Personeli ndihmës akademik kishte kryer studime të larta në fushën e teknikave dentare dhe kishin një eksperiencë shumë vjeçare në teknika digjitale dhe laboratorë dentare. Në institucion, pranë Departamentit të Protetikës ishin punësuar edhe punonjës të rinj ndihmës akademikë për realizimin e praktikave mësimore në laboratore dentare dhe klinika stomatologjike. Ato ishin 4 individë të diplomuar në Bachelor në Teknikë të Lartë Dentar apo kishin titull Mjeshtër i Teknikës Dentare nga Shkolla e Mjeshtërisë në Gjermani(A25).</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjës për zhvillimin, ecurinë dhe mbarë vajtjen e programit ishte një person i cili caktohet si koordinator i programit të studimit. Koordinatori ishte gjithashtu përgjegjës për ecurinë e praktikave profesionale, në përputhje me objektivat e institucionit. Koordinatori kryente takime të vazhdueshme me titullarin e njësisë përkatëse, në të cilat informonte vazhdimisht mbi ecurinë e programit (A26).</p>



Konkluzione	<p><i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit i përmbush detyrimet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, si me personel akademik, ashtu edhe me personel ndihmës akademik apo administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike dhe klinike, duke caktuar një koordinator të programit të studimit.</i></p> <p><i>Megjithatë GVJ mendon se personeli Akademik duhet të zhvillohet në mënyrë që institucioni të ketë një numër më të lartë pedagogësh me grada shkencore. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X




Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>FTD ishte njësia kryesore përgjegjëse për organizimin e programit të studimit Master profesional në 'Teknika digjitale dentare'. Njësia kryesore përcaktonte programin mesimor të lëndës, bazuar në kurrikulën e programit mesimor. Plani mesimor pëmbante informacionin e nevojshëm mbi kursin, mënyrën e organizimit të kursit, semestrin në të cilin zhvillohej kursi, mbi lektorët e moduleve, llojin, objektivat dhe kohë zgjatjen e modulit, kreditet e moduleve përcaktuar në ECTS, objektivat e modulit, metodat e vlerësimit dhe literaturën përkatëse, si dhe detyrimet e studentit për cdo modul, dhe detyrimet përmbyllëse. Plani mesimor ishte objekt rishikimi nga institucioni, dhe cdo vit pas diskutimit të këtij plani, ky miratohej nga Dekani dhe Rektori (A3, B13).</p> <p>GVJ vlerësoi rregulloren e programit, kurrikulën e programit, planin mesimor, syllabuset e lëndëve si dhe përcaktimin apo ndarjen e lëndëve sipas veprimtarive formuese. Lëndët/modulet ishin të kategorizuara në: -Lëndë bazë, që jepnin përgatitje metodologjike dhe formim të përgjithshëm dhe përmbanin 6 kredite, -Lëndë të formimit karakterizues, të cilat jepnin një përgatitje të përgjithshme për disiplinën shkencore dhe përmbanin 24 kredite, -Lëndë ndërdisiplinore/integruese: të cilat ishin të ngjashme dhe plotësuese me lëndët karakterizuese plus lëndë formuese të zgjedhura nga vetë studentët, të cilat përmbanin 18 kredite - Lëndë plotësuese, të cilat ndihmojnë në formimin e studentit dhe aftësimin e tyre për të lehtësuar hyrjen në tregun e punës, të cilat përmbanin 5 kredite - Detyrime përmbyllëse: në përfundim studenti paraqitet me tezën e diplomës ose me provimin e formimit (12 kredite). Ndarja e lëndëve dhe moduleve ishte konform kërkesave ligjore.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mesimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mesimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Plani mesimor specifikonte gjithë informacionin e nevojshëm mbi kursin, mënyrën e organizimit të kursit, semestrin në të cilin zhvillohej kursi, mbi lektorët e moduleve, llojin, objektivat dhe kohë zgjatjen e modulit, kreditet e moduleve përcaktuar në ECTS, objektivat e modulit, metodat e vlerësimit dhe literaturën përkatëse, si dhe detyrimet e studentit për cdo modul, dhe detyrimet përmbyllëse. (B13)</p>

<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Mënyra e pranimit dhe seleksionimit të studentëve në programin e studimit Master profesional në ‘Teknika digjitale dentare’ përcaktohet nga FTD, sipas rregullores së saj. Institucioni vendoste kriteret specifike në varësi të aplikimeve, si dhe udhëzimet nga Ministria përgjegjëse për arsimin e lartë përsa i përket mënyrës së aplikimit për studentët si dhe seleksionimit të tyre në program, dhe këto ishin të publikuara në faqen e internetit të AI. Institucioni kishte parashikuar në rregulloren e tij transferimin e studimeve, transferimin e studimeve në të njëjtin cikël studimesh, procedurat e transferimit si dhe ekuivalentimi i programeve të studimeve për studentët që transferoheshin. Programi i studimit parashikonte dhe rregullonte edhe transferimet dhe ekuivalentimin e studimeve drejt IAL-ve të tjera.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit MP në TDD përmbante gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me kursin, me syllabuset përkatëse të lëndëve, moduleve, kreditet e cdo lënde dhe moduli, organizimin e orëve të leksioneve, seminareve dhe laboratorit, të përcaktuara brenda dhe jashtë autorit, sipas formateve përkatëse të miratuara (B13).</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Institucioni, para fillimit të cdo viti akademik shqyrtonte të gjithë programet e studimit, në mënyrë që këto të ishin në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Programi i studimit ishte përshtatur në mënyrë që të përputhej me nevojat e tregut vendas. Programi i studimit ishte hartuar në vitin 2020 duke u bazuar në eksperiencat europiane, si ato gjermane, angleze, amerikane e kanadeze, për ndërtimin e kurrikulave studimore që mundësonin formimin e specialistëve në teknikat digjitale dentare. AI ofronte trajnime të vazhdueshme. Programi MP në TDD ishte hapur në vitin 2021-2022 dhe në përgatitje për vitin aktual 2022-2023 ishin parë syllabuset, ishin bërë përmirësime të tyre, duke përdorur fondin e librit në bibliotekën e AI (A26). Kurrikula rishikohej cdo vit, duke bërë ndryshime, nëse vlerësohej e nevojshme, sipas përqindjeve të lejuara nga statuti i AI dhe ligjet përkatëse. Procedurat e rishikimit bëheshin në bashkëpunim midis grupeve të punës së departamenteve dhe NJSBC. Në disa raste kërkohej asistencë teknike e personelit akademik në varësi të programeve të studimit, duke mundësuar kështu unifikimin e formateve të syllabuseve në nivel institucional (B14).</p>




Konkluzione	<p><i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit, sipas planit mësimor, ngarkesës mësimore/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit, etj. Ky program përmban informacionet e nevojshme për lëndët (syllabuset) për secilën lëndë, praktikat, seminarët, orët e laboratorit në përputhje me formatet e miratuara dhe të përditësuara në cdo vit akademik.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi II.4	
<p>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i programit të studimit Master profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ ishte i ndërtuar në mënyrë të atillë që të ofronte një bazë të mjaftueshme njohurish në fushën e teknikave dentare digjitale dhe dentistrisë estetike. Ky program ishte i hartuar bazuar edhe në kërkesat e punës të vendit tonë, duke ju mundësuar studentëve punësim në një shkallë të gjerë. Komponentët mësimore ishin në funksion të ndërlidhjes dhe interaktivitetit të studentëve me pedagogë përkatës të lëndes dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe praktik. Lëndët ishin të organizuara duke stimuluar më shumë përmbajtjen e orëve laboratorike dhe praktike në laboratorin e teknikave digjitale dhe laboratorine qeramikës estetike. Studentëve kishin mundësinë të praktikoheshin edhe jashtë orarit në ambjentet e institucionit, si dhe në fundjavë, për realizimin e punimeve të ndryshme protetike dentare. Në këto orare studentete mund të punonin edhe në pacientë reale, gjë që rriste mundësinë e punësimit të menjëhershëm të studentëve pas diplomimit të tyre (A26).</p>




<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Veprimtaritë formuese ishin përcaktuar në mënyrë të tillë që të garantonin kohën e nevojshme për studentetë për të fituar njohuritë e nevojshme si dhe mundësinë që ti aplikonin ato në formë praktike. Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve bënin të mundur njohjen të krediteve/ vazhdimin e studimeve më tej në studime të programeve të ngjashme të ciklit të dytë e të tretë. Kreditet e Master profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ ekuivalentoheshin dhe njiheshin edhe jashtë vendit, në programe mësimore të ciklit të tretë, aty ku afroheshin doktoraturat në fushën e protetikës(A27). Njohja e krediteve jashtë vendit bënte gjithashtu të mundur punësimin e studentit jo vetëm në vendin tone, por edhe në vendë të tjera.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Plani mësimor përcaktonte ndarjen e orëve për cdo lëndë /modul, në formë leksionesh, seminaresh apo laboratorësh, duke përcaktuar edhe kreditet e cdo disipline. Lëndë të caktuara, në varësi të specifikave të tyre, aplikonin edhe seminare klasike, por më shumë ishin të fokusuar drejt praktikave të studentëve, nëpërmjet orëve laboratorike ose praktikave mësimore. Në disa lëndë aplikoheshin detyra/projekte kursi me studentët, për ti nxitur ata krijonin në mënyrë të pavarur (B13). Në lëndë të cilat trajtonin materiale të reja dentare, etj, studentët kishin hapësirë të formoheshin dhe orientoheshin në kërkimin shkencor, duke marrë pjesë në projekte ndërkombëtare dhe duke paraqitur rezultatet e tyre në konferenca shkencore (A28, A29).</p>



<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit MP në TDD ishte organizuar duke marrë për bazë programe të ngjashme ndërkombëtare si Msc në “Dental Technology” nga Universiteti i Esheffield, Angli; Msc në “Digital Dental Technology” nga Universiteti i Bolton, Angli, Master në “Digitale Dental Technologie” nga Universiteti i Greifsäald, Gjermani.</p> <p>Natyra e moduleve dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguronte një integrim të pjesës teorike dhe praktike të cdo moduli. Programi ruante raportet e paracaktuara me lëndët karakterizuese të tipit B, me 24 kredite ECTS ose 40% lëndë bazë të llojit A me 6 kredite ECTS, ose 10% lëndë ndërdisiplinore të llojit C me 18 kredite ECTS, ose 21,7% lëndë plotësuese të llojit D me 5 kredite ECTS, ose 8,3% dhe detyrime përmbyllëse të llojit E me 12 kredite ECTS ose 20%. Programi Master profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ fokusohet drejt orëve maksimale të praktikave laboratorike që lejonte VKM 41 për programin MP, kjo sepse vetë programi synonte plotësimin e tregut me specialistë që të ishin të afte të përdornin teknika të avancuara të teknologjisë dentare digjitale të kombinuar me materialet dhe inxhinierinë biomjekësore. Programi përbante lëndë të cilat synonin njohjen dhe aftësimin në aplikimin e teknikave digjitale në punime protetike dentare të ndryshme, implantoprotezë, ortodonci, etj, dhe ishin të organizuara më një raport teori/praktikë të orientuar më shumë drejt praktikave në laborator (B13).</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Institucioni shqyrtonte cdo vit ecurinë e programit, duke nxjerrë vlerësimin e performances së mësimdhënies, e cila realizohej nga Departamenti i Protetikës, pasi diskutonte këto të dhena edhe me personelin akademik, ndihmës akademik, studentët dhe bashkëpunëtorë të jashtëm të AI, vendas dhe të huaj (A16). Në vlerësimin e ecurisë së programit merrej parasysh programi i studimit, stafi akademik i rekrutuar, instrumentat e blerë, aparaturat e reja të integruara, pajisja e bibliotekës, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtarinë kërkimore shkencore, etj. në fund të analizës njësia bazë ndërtonte SWOT dhe përcaktonte masat e nevojshme që do të merreshin për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Ofrimi i programit të studimit monitorohej në mënyrë kostante edhe nga NJSBC, i cili siguronte përputhshmërinë me standartet e cilësisë (A30). Syllabuset ishin ndërtuar në përputhje me ligjin e pasqyronin informacionet mbi lëndën, konceptet themelore, temat e përfshira, format e kontrollit të dijeve, literaturën, etj. Syllabuset rishikoheshin cdo vit, kjo edhe për faktin se në AI ishin implementuar vazhdimisht aparatura të reja, të cilat sillnin nevojën e aplikimit në syllabus në mënyra të përdorimit dhe aplikimit të tyre (A32). Titullarët e lëndëve, së bashku me stafin</p>




	akademik ndihmës siguroheshin që literatura të ishte e viteve të fundit dhe konform programit të studimit (A31, B15, A32).						
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Programi Master Profesional në 'Teknika Digjitalë Dentare' përmbante njohuri profesionale për aplikimin e teknikave tradicionale dhe ato digjitale në laboratore apo klinika dentare, mbi fushat e protezave dentare dhe punimeve estetike dentare. Programi ishte i fokusuar kryesisht në përdorimin dhe aplikimin e softwereve digjitale, aparaturave dhe materialeve moderne estetike në dentistrinë digjitale. Programi ishte i ndërtuar në mënyrë që studentët të krijojnë eksperiencë mbi sistemin CAD-CAM, për planifikimin dhe prodhimin e punimeve të ndryshme protetike me materiale qeramike. Një prej kushteve të pranimit në këtë program ishte njohja paraprake nga studentët e teknikave tradicionale dhe punimeve të punës bazë të përgatitjes së protezave dentare dhe aparateve ortodontike, pasi aplikimi i teknikave digjitale kërkonte aftësim shumë të mirë teknik nga profesionistët e fushës në mënyrë që të arrijë objektivin e tij të plotë(B1).						
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Programi i studimit Master Profesional në 'Teknika Digjitalë Dentare' ishte menduar duke u bazuar mbi kërkesat dhe mungesat e tregut vendas lidhur me aplikimin e teknikave digjitale në dentistrinë. Falë këtyre njohurive, studentët mund të punësoheshin në klinika apo laboratore brenda dhe jashtë vendit, duke qënë se trendi sotëm ishte drejt teknikave digjitale të përgatitjes së protezave të ndryshme. Institucioni gjithashtu parashikonte në strategjinë e asaj afat mesme hapjen e programeve të specializuara në fusha të ngushta të ciklit të dytë e të tretë të studimit, duke aplikuar për vitin akademik 2023-2024 hapjen e një programi të ri Master Shkencor dy vjeçar (A2 A27).						
Konkluzione	<i>Lëndët/modulet janë të shpërndara në mënyrë të atillë që të mundësojnë thellimin e njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme, punësimin e studentëve si dhe rezultate të pritshme të vazhdimin të kërkimit shkencor. Ndarja e veprimtarive formuese, raportet midis formimit teorik/praktik mundësojnë arritjen e objektivave, transferimin e studimeve, mobilitetin, si dhe punësimin në përfundim të programit, gjithmonë duke realizuar përditësimin e tyre. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Programi Master Profesional në ‘Teknika Digjitale Dentare’ ishte hartuar nga stafi Akademik i Akademisë Ivodent në bashkëpunim me lektorë nga IAL, qendra të edukimit dentar pranë prodhuesve të aparaturave të materialeve brenda dhe jashtë vendit, si Akademia Ivoclar dhe 3shape, në kuadër të marrëveshjeve institucionale që Akademia Ivodent kishte me ta. Gjithashtu ishin marrë mendime nga studentë të diplomuar më parë në Akademinë Ivodent që ushtronin profesionin e tyre në treg, duke marrë shkas nga eksperiencia e tyre. Marrëveshjet e bashkëpunimit kishin mundur, përveç kontributit në hartimin e syllabuseve dhe kurrikulës, edhe mësimdhënien nga pedagogë të Albanian University dhe Universitetit Politeknik të Tiranës (A6, A6.1, A6.2, A6.3, A6.4, A6.5, A6.6). Në hartimin e pjesës praktike të programit kishte një kontribut të lartë bashkëpunimi me qendrat e edukimit dentar 3Shape dhe Ivoclar Academy, lektorët e të cilave ftoheshin edhe të organizonin workshope extrakurrikulare, duke integruar të rejtat e zhvillimit të industrisë (A.13).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni me ane të NJSBC monitoronte vazhdimisht standartet e cilësisë së ofrimit të programit të studimit, si dhe publikonte në faqen zyrtare informacione lidhur me cilësinë e zhvillimit të veprimtarive. Në vlerësimet e saj, Akademia bazohej edhe në mendimet e Këshillit studentor dhe anketimet e studentëve institucioni mbante kontakte të vazhdueshme me studentë të diplomuar më parë në këtë akademi, të cilët konsultoheshin duke dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e programit dhe mirë mbajtjes së tij. Institucioni kishte lidhje të shumta me biznese të ndryshme, të cilat jepnin kontributin e tyre në programe financimi, si dhe në zhvillimin e teknikave digjitale. Në disa prej këtyre bizneseve, të cilat ishin laboratore dentare, ishin të punë suar ose në pozicione drejtuese edhe studentë të diplomuar në Akademinë Ivodent, të cilët jepnin ide dhe njohuri lidhur edhe me përmirësimin e syllabuseve të programit. (A33, A34)</p>



Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.

Programi i studimit Master Profesional në 'Teknika Digjitale Dentare' ishte hartuar prej vetëm një viti, ndaj përmirësimet lidhur me këtë program ishin fokusuar në përmirësimin e syllabuseve, të infrastrukturës, investimin në aparatura dhe materiale të reja si psh: Exocad Rijeka, Cad-Cam Programill PM7, Scaneri laboratorik PS5, Scaneri intraoral 3Shape Trios4, Printeri 3D Anycubic Mono X, të cilat ishin integruar gjatë vitit 2022. Syllabuset ishin përmirësuar bazuar në inserimin e njohurive lidhur me përdorimin e këtyre aparaturave të reja, të aplikuara në prodhimin e protezave dentare. Në drejtimin e zhvillimeve kishin ndikuar edhe bashkëpunëtorë ndërkombëtarë, si Akademia Ivoclar dhe Akademia 3Shape, të cilat kishin zhvilluar trajnime me personelin akademik dhe ndihmës akademik mbi aplikimin e këtyre teknologjive. Financimi nga Akademia Ivodent në kuadër të përmirësimit të cilësisë së programit ishte lidhur edhe me përgatitjen metodike profesionale të stafit akademik në aktivitete kërkimore, shkencore, referime në kongrese, shkolla verore; nxitjen në pjesë marrjen në projekte ndërkombëtare, etj. Cdo Departament mbante kontakte me pedagogët lidhur me mënyrën e mësimdhënies, vlerësimit, veprimtarisë shkencore, si dhe trajnimet e cdo pedagogu. Akademia me qëllim përmirësimin e programeve, syllabuseve, organizimit mësimor, etj, merrte mendimet e pedagogëve, por gjithashtu edhe të alumni-ve të diplomuar në këtë akademi, si dhe studentëve. Një kërkesë studentore e cila ishte marrë parasysht dhe aplikuar nga institucioni ishte propozimi i studentëve për më shumë praktikë laboratorike në lëndën 'Përpunimi estetik i protezave prej zirkoni dhe dilithiumsilikati'. Në këtë mënyrë ngarkesa e lëndës ishte modifikuar duke fokusuar orët në ato laboratorike dhe praktika. (A13, A32, B16, A35, A36, A37, A38).

Konkluzione	<p><i>Për përmirësimin e përmbajtjes së programit, duke e përshtatur me mirë me kërkesat e tregut, njësitë përgjegjëse konsultohen rregullisht dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve si dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës, pa nënvlerësuar avancimin e teknologjisë mjekësore në botë dhe në vendin tonë.</i></p> <p><i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Hapja e programit Master Profesional në ‘Teknika digjitale dentare’ kishte si qëllim zhvillimin arsimor, shkencor e profesional të specialistëve të teknikave dentare, dhe synonte përmbushjen e një mungesë evidente në treg për specialistë që të njohin këto teknika. Programi i studimit MP në TDD bazohej në eksperiencën e vendeve më të zhvilluara në fushën e teknikave dentare. Programi kishte për qëllim aftësimin e mjekëve stomatologë dhe teknikëve dentarë në njohjen dhe përdorimin e teknikave digjitale në prodhimin e protezave dentare. Akademia stimulonte stafin Akademik në zhvillimin e kërkimit shkencor, i cili fokusohet kryesisht në përmirësimin e materialeve dentare dhe digjitalizimin e njohurive të teknologjisë analoge të laboratorit dentar.</p> <p>(A1, A2, A39, B1).</p>

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.

Fakulteti i Teknikave Dentare dhe Departamenti i Protetikës siguronin lirinë akademike individuale të personelit akademik falë akteve të tyre rregullatore. Personeli akademik kishte liri të plotë në organizimin e metodës së mësimdhënies, hartimin dhe ndryshimin e syllabuseve të lëndëve, literaturës bazë e të rekomanduar, etj. Syllabuset shqyrtoheshin dhe pranoheshin nga përgjegjësi i njësisë bazë, duke qëndruar konform ligjit dhe akteve nënligjore.


Liria e kërkimit shkencor garantohej në aktet rregullatore të institucionit. Ai parashikonte financime për projekte kërkimore, pjesëmarrje në kongrese, apo vizita në IAL dhe institucione partnere. Personeli Akademik paraqiste propozimet e projekteve të kërkimeve shkencore pranë Komisionit të Mbështetjes së Kërkimit Zhvillimit ku ato vlerësoheshin. Aplikimi për fondet nga Akademia Ivodent kryhej sipas procedurës transparente të përcaktuar nga Udhëzimi i Rektorit të AI. Gjatë vitit 2022 ishin financuar 2 pjesëmarrje në shkolla verore, 15 pjesëmarrje në Konferenca shkencore, dhe dy projekte kërkimore në fushën dentare. Kërkimet shkencore ishin kryer në laboratorët kërkimore të AI si dhe ato të institucioneve partnere, si Instituti i Kristalografisë (CNR, Bari dhe Rome - Itali) dhe Universiteti Politeknik i Tiranës dhe ishin publikuar në revista dhe prezantuar në Konferenca.

Personeli Akademik mund të organizonte dhe përdorte lirisht mënyrat moderne të mësimdhënies, pasi sallat e leksioneve, praktikave dhe laboratorëve ishin të pajisura me sisteme audiovizive, (A7).

Pajisja e sallave dhe laboratorëve me materiale, instrumenta dhe aparatura të nevojshme parashikoheshin në buxhet dhe realizoheshin çdo fillim viti Akademik. Konsideruar numrin e vogël të studentëve, nëse ishin të nevojshme furnizime emergjente, këto realizoheshin me procedura jo burokratike nëpërmjet sekretarisë mësimore, duke plotësuar shpejt mungesat pa dëmtuar procesin mësimor.

(A1, A3, A10, A11, B14, A40, A42, A43)

<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Akademia Ivodent nxiste dhe mundë sonte pjesëmarrjen e studentëve në kërkime shkencore, të cilët aplikonin pranë Qendrës së Studimit të Teknikave Dentare. Masteri profesional në TDD përfshinte në program edhe lëndën e ‘Metodika Shkencore’ ku studentët pajiseshin me njohuritë e metodologjive të kërkimit shkencor. Tematikat e kërkimeve shkencore korrespondojnë me qëllimet e programit të studimit, si dhe për rmirësimin e metodave apo materialeve të ndryshme të përdorura në dentistri. Studentja Antonina Mema ishte e përfshirë si pjesë e ekipit kërkimor nga AI në aplikimin e bërë me temë ‘Nanomateriale inovative mbi bazën e fluorhidroksiapatiteve për aplikime në dentistri’ në 7 Nëntor 2022 pranë AKKSHI nëkuadrin e programit bilateral Itali - Shqipëri me partner Institutin e Kristalografisë në Romë (CNR, Itali).</p> <p>(A28, B1, B14).</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Projektet kërkimore shkencore mund të propozoheshin nga njesitë bazë nga grupet kërkimore dhe kërkues të vecantë të tyre, vetëm apo në bashkëpunim. Kërkimet shkencore dhe projektet financoheshin në cdo Departament nga buxheti i AI për shkencën. Në vitin 2022 ishin financuar dy projekte në fushën e shëndetit oral, me një financim prej 770.000lek dhe 392.000 lek, rezultatet e të cilave priteshin të publikoheshin në konferenca. Projektet e propozuara ishin në linjë me strategjitë e kërkimit të përcaktuara nga njesitë kryesore dhe zgjasnin për një periudhë deri në një vit. Financimi i projekteve kalonte sipas fazave të poshtë cituara: thirrja për propozimin e projekteve, paraqitja e projektit, kontrolli formal i projektit, përcaktimi i projekteve fituese, lidhja e kontratës, dhe së fundmi monitorimi dhe raportimi i rezultateve të projektit. Mjetet dhe infrastruktura për realizimin e projekteve kërkimore siguroheshin nga institucioni.</p> <p>(A42, A44, A45)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit ka të përcaktuara qartë prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor. Njësia kryesore/bazë nxit veprimtarinë e mësimdhënies, ato kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike në këtë fushë. Programi, gjithashtu, nxit studentët të angazhohen në projekte dhe aktivitete kërkimore, duke i mbështetur ata financiarisht nga institucioni. Nga personeli akademik kërkohen më shumë artikuj apo referime në aktivitete dhe revista prestigjioze ndërkombëtare. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet përmesisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Personeli Akademik i AI nxitej të zhvillonte kërkimin shkencor në bashkëpunim me institucione partnere. Një bashkëpunim ishte ai me Universitetin Politeknik të Tiranës dhe Institutin e Kristalografisë në Romë, Itali. Të tre institucionet zhvillonin kërkim me interes të përbashkët në fushën e nanomaterialeve me aplikime në dentistrinë. Ky bashkëpunim kishte sjellë edhe aplikimin në programin bilateral të mbështetjes së kërkimit Shqipëri - Itali nga AKKSHI, në 7.11.2022, ku AI ishte partneri shqiptar. Përveç financimit nga AKKSHI, projekti do të financohej edhe nga vetë institucioni i AI me një shumë prej rreth 300.000 Lek (A28).</p> <p>Institucioni ishte krijuar fondin e 'Buxheti për kërkimin' për vitin 2022, për të mbështetur kërkimin shkencor të aplikuar nga personeli dhe studentët e AI. Udhëzimi i Rektorit për këtë fond parashikonte thirrjen për propozimin e projekteve, paraqitjen e projektit, kontrollin formal të projektit, përcaktimin e projekteve fituese, lidhjen e kontratës, dhe së fundmi monitorimin dhe raportimin e rezultateve të projektit. Njësia kryesore, njësia bazë dhe stafi akademik hartonin projektet kërkimore, propozimet dhe grupet e punës të përfshira në to, duke parashikuar mbështetjen e nevojshme materiale. (A40, A41).</p>




Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.


Departamenti i protetikës dhe institucioni ruanin marrdhënië kostante komunikimi me profesionistë shqiptarë e të huaj në fushën e protetikës dentare. Akademia financonte personelin Akademik të merrte pjesë në konferenca shkencore ku diskutoheshin sfidat që merrnin zgjidhje nëpërmjet kërkimit shkencor të aplikuar. Një kongres i rëndësishëm ishte ai i organizuar nga Shoqata e Materialeve Dentare (ADM) në Athinë në gusht 2022, ku institucioni kishte financuar pjesë marrjen e dy përfaqësuesve nga personeli akademik i AI, te cilët kishin bërë atje prezantime poster mbi rezultatet e projekteve kërkimore të kryera gjatë vitit 2021-2022 me financim edhe në laboratorët e AI. Gjitashtu, në 1-12 nëntor 2022, ishte organizuar një konferencë në Beograd, ku kishin marrë pjesë me financim të AI 2 studentë dhe 5 personel Akademik dhe ndihmës akademik nga AI të financuar nga Akademia Ivodent.

AI zotëronte aparatura të komanduara nga kompjuteri apo manuale për prodhimin e protezave dentare të përshtatshme për zhvillimin në të projekteve të kërkimit shkencor lidhur me teknikat e prodhimit të protezave dentare si CAM (PM7, prodhuesi Ivoclar Litenstejn), Printer 3D (Varseo, prodhuesi BEGO, Gjermani), scanera intraorale dhe laboratorike, etj. Laboratorët kërkimore mësimore të AI ishin të pajisur me aparatura moderne dhe ishin në gjendje të ofronin analiza e shërbime në fushën e materialeve në dentistri dhe protezave dentare për tregun vendas e të huaj (A32). Aparatura analitike si ajo për matjen e ndryshimeve termike të materialeve dentare STA (prodhuesi Netzch, Gjermani), matjen e sipërfaqes specifike të porozitetit të materialeve dentare ishin të vetmet në vendin tonë dhe të disponueshme e në përdorim nga personeli Akademik dhe ndihmës akademik.

(A6.5, A12, A35, A38)




<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Qëllimi kryesor i Masterit profesional në ‘Teknika digjitale dentare’ ishte rritja e njohurive dhe aftësimin në fushën e teknikave digjitale të aplikuara në dentistri. Për këtë arsye, insitucioni organizonte edhe konferenca me tematika lidhur me prirrjen e kompetencave dhe kapaciteteve në fushën e stomatologjisë digjitale estetike. AI kishte planifikuar organizimin e një konference shkencore për vitin 2023, ku një prej tematikave kryesore do të ishte edhe dentistria digjitale. MP në TDD ishte hapur prej vetëm një viti, dhe gjatë kësaj periudhe aktiviteti shkencor i saj ishte përqëndruar në organizimin e trajnimeve praktike hands/on me profesionistë nga institucione partnere si Akademia Ivoclar. Institucioni gjithashtu mbështeste stafin akademik me financime për pjesë marrje në konferenca, sic ishte rasti i konferencës së organizuar në Beograd, Serbi në 1-12 nëntor 2022 ku morën pjesë me financim të AI 2 studentë dhe 5 personel Akademik dhe ndihmës akademik nga AI të financuar nga Akademia Ivodent. (A2, B10, A36)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Programi i studimit MP në TDD fokusohet në përgatitjen e teknikëve dentare dhe mjekëve stomatologë mbi përdorimin e teknikave moderne digjitale dentare. Synimi i këtij programi bazohet edhe në faktin se tashme edhe fusha e stomatologjisë po shkon gjithmonë e më shumë drejt proceseve digjitale, gjë që sjell një kërkesë të lartë për specialistë që të njohin dhe aplikojnë teknikat dhe rrjedhën digjitale të punës në klinikë dhe laborator. Ky fakt mund të vërehet edhe në agjendat e punësimit në vende europiane, si psh Gjermania. Sipas të dhënave të institucionit, Punësimi i gjeneratës së parë të studentëve në vitin 2022 ishte 100% në laboratore brenda dhe jashtë vendit. (A12, B17).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>Sipas legjislacionit për profesionin e teknikut dentar, përcaktohej se teknikët dentarë licensohen në Shqipëri nga Urdhëri i Infermierit të Shqipërisë. Vlerësimi i aftësive në këtë profesion nuk parashikonte provim por kryhej bazuar në vlerësimin e programit të studimit të kryer nga kandidati (www.uish.al). Institucioni respektonte si dhe ndiqte me vëmëndje ndryshimet në legjislacionin për licensimin në profesionin e teknikut dentar nëpërmjet ligjeve dhe ndryshimeve në to, VKM, urdhërave, udhëzimeve e rekomandimeve nga shoqatat e rrjeteve të profesionistëve si Urdhëri i Stomatologut, Shoqata Dentare Shqiptare, Urdhëri i Infermierit, etj. Studentët e programit TDD që kishin kryer Bachelor në fushën e teknikave apo teknologjisë dentare, licensoheshin edhe me studimet e tyre të mëparshme për të ushtruar profesionin e teknikut dentar në vendin tonë.</p>




<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).</p>	<p>Profesioni i teknikut dentar nuk klasifikohet në profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë. Në listën e profesioneve të vendit tonë ky profesion klasifikohet nëpërmjet VKM nr. 514, datë 20.09.2017 'Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar' me kodin e profesionit 3214. Në direktivën europiane 2005/36/EU, ky profesuin parashikohet të ushtrohet pas një edukimi prej gjithsej 14 vitesh, nga të cilat formim i përgjithshëm dhe të paktën 2 vite formim profesional si Teknik Dentar. (ë ë ë.directive_2002_36ec.pdf).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore duke bashkëpunuar me struktura të tjera për realizimin e objektivave të programit në kërkim shkencor. Ajo gjithashtu u përgjigjet kërkesave për analiza, studime dhe projekte, duke angazhuar personelin akademik dhe studentët për përmbushjen e këtyre objektivave. Njësia përgjegjëse ka organizuar konferenca dhe aktivitete shkencore që kanë ndihmuar personelin akademik dhe studentët. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>
---	------------------------------	-----------------------------	------------------------------	----------




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit MP në TDD bazohej në syllabuset e lëndëve dhe ishte i organizuar në leksione, seminarë, detyrat dhe projekte, punë laboratorike dhe praktika mësimore, të cilat realizoheshin në përputhje me planin mësimor. Syllabuset përcaktonin formën dhe metodat e mësimdhënies, përmbajtjen e lëndës, ndarjen sipas orëve, etj. Lëndët bazë ishin parashikuar të jepnin njohuritë përmes leksioneve, seminarëve dhe detyrave të kursit. Konsideruar llojin e programit të studimit që institucioni ofronte, organizimi i Master Profesional në 'Teknika Digjitale Dentare' ishte më i përqëndruar drejt praktikave profesionale, ndaj raporti teori/praktikë ishte ruajtur në minimalen që lejonte VKM në favor të praktikave. (B13). Programi nuk parashikonte praktika profesionale, kjo pasi gjatë praktikave mësimore studentët kryenin punë që vinte prej bashkëpunimit me klinika dentare të cilat sillnin punime nga pacientë reale. Provimi përfundimtar kryhej në formë praktike, ku studentëve i kërkoheshin të realizonin një proteze dentare komplekse individuale që secili prej studentëve duhet të përgatiste duke patur në dispozicion një periudhë kohore 3 javore. (B1).




Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.

Në programin e studimit ishin integruar forma të ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies, dhe kontrollit të dijeve, të cilat ishin në përputhje me syllabuset e lëndëve si dhe fushën apo natyrën e programit të studimit. Gjatë mësimdhënies dhe praktikave laboratorike shfrytëzohej hapësira e laboratorëve mësimore për të realizuar punime prototipe për pacientë reale, duke marrë punë të ndryshme nga klinika dentare me të cilat institucioni kishte bashkëpunim. Në akademi aplikoheshin edhe forma e mësimdhënies online, konsideruar se një pjesë studentëve të TDD ishin të punësuar ose vetëpunësuar apo prindër, ndaj mësimdhënia ishte përshtatur edhe për nevojat e tyre. Kjo organizohej në platformën 'Google Classroom' sipas Google Education, e cila përdorej për komunikimin e vazhdueshëm midis pedagogëve dhe studentëve, dhe shfrytëzohej gjithashtu për publikimin e leksioneve në mënyrë që studentët të kishin akses të vazhdueshëm në to, për publikimin e literaturës nëpërmjet librarisë online. Në platformë publikoheshin edhe demonstrime praktike të realizuara dhe regjistruara në laboratorët e Akademisë, të cilat studenti mund ti aksesonte në çdo kohë. (<https://ivodent/-app-pages.dev>).



Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.


Infrastruktura lejonte dhe mundëonte përdorimin e teknologjisë dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies në dispozicion të personelit Akademik. Në procesin e hartimit të buxhetit për cdo vit Akademik, personeli parashtronte kërkesate lidhura me përmirësimin e mësimdhënies, këto lidhur me aparatura të nevojshme, softwere të reja, materiale të ndryshme dhe instrumenta për realizimin e mësimdhënies, blerje librash të rinj dhe materialesh didaktike me pagesë nga interneti apo vizitash në aktivitete shkencore me interes didaktik. (A26). Në vitin Akademik 2022-2023 institucioni kishte investuar në blerjen e softwereve Exocad, scanner intraoral Trios, scanner laboratorik PS5. Institucioni kishte investuar gjithashtu në krijimin e sallave digjitale, ku përfshiheshin 23 komputera, 1 monitor, salla te pajisura me videoprojektor, 4 laboratorë me pajisje moderne bashkëkohore. Konsideruar se natyra e MP në TDD ishte një degë në evolucion të vazhdueshëm, biblioteka pasurohej në mënyrë kostante me tekste të nevojshme për zhvillimin e programit, insistimin e vazhdueshëm të teksteve të reja sipas zhvillimit të teknologjisë, etj. Gjatë orëve laboratorike, pedagogu mund të demonstronte dhe regjistronte punime praktike nëpërmjet mikroskopeve/kamerave që ishin të lidhura me kompjuterin apo videoprojektorin. Në këtë mënyrë studentë mund të ndiqnin në monitor live demonstrimet, si dhe mund të rikonsultonin regjistrimet e tyre në cdo kohë fale aksesit online në platformë Google Classroom të akademisë. Institucioni financonte edhe pjesë marrjen e personelit Akademik dhe ndihmës të angazhuar në të, në aktivitete si simpoziume, leksione të hapura, workshope dhe konferenca, brenda dhe jashtë vendit, financuar nga AI. Falë marrëveshjeve me institucione partnere si 3Shape Academy dhe Ivoclar Academy, personeli Akademik përftonte edhe trajnime të ndryshme të organizuara prej tyre. (A13, A32, A36, A37, A38, A46).



Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit plotësonte kriteret ligjore të kualifikimit të përcaktuara nga ligji. Stafit Akademik zotëronte kompetencat e nevojshme për shpjegimin e koncepteve dhe njohurive për këtë program studimi, gjë që u konstatua edhe nëpërmjet vlerësimit të curriculumeve të stafit Akademik, që vërtetonte se fusha e tyre e specializimit dhe kualifikimit ishte në përputhje me fushën e tyre të mësimdhënies. (B7, B8). Verifikimet e realizuara në Departament midis stafit Akademik së bashku me anketimet e studentëve të organizuara nga NJSBC, shë rbenin për të përmirësuar format e mësimdhënies. Personeli Akademik aplikonte forma dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies, konform fushës së lëndës dhe natyrës së programit të studimit, përfshirë forma të mësimdhënies në auditore apo laboratorë, por edhe në formë online nëpërmjet platformës Google Education. Në fillim të seminareve, realizohej një testim i njohurive përsa i përket plotësisimit të protokolleve të hapave praktike të procedurës në laborator, të cilat publikoheshin në faqen web të AI. Në këtë mënyrë nxitej tek studentët mendimian krijues e kritik. Pedagogët gjatë prezantimit të leksioneve, në formë slidesh apo videoregjistrimeve, i jepnin mundësinë studentëve te shumulonin mendimet e tyre krijuese dhe kritike dhe të përfshiheshin në diskutime mbi mënyrat e ndryshme të zgjidhjes së problemeve nëpërmjet protezimit dentar. Gjatë praktikave mësimore, studentë t punonin mbi raste pacientësh realë, gjë që rriste edhe më tej eksperiencën praktike dhe nxitjen e diskutimit për zgjidhjen e rasteve të ndryshme. Për studentët e dobët apo ata që vinin nga fakultete ku nuk aplikoheshin njohuri të avancuara mbi teknikat dentare, bëhej edhe punë e pavarur nëpërmjet konsultimeve për sqarime të temave të vecanta. (A34, A30) (A47, A48).

<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Veprimtaria akademike e personeli Akademik monitorohej dhe vlerësohej nga departamenti dhe NJSBC. NJSBC kishte organizuar pyetësorë me studentët, nëpërmjet të cilave vlerësonte vazhdimisht mësimdhënien nga stafi akademik, e të cilat dorëzoheshin pranë departamenteve përkatëse, me qëllim konfirmimin e ecurisë sipas misionit dhe qëllimeve të institucionit, si dhe përmirësimin në vazhdim. Institucioni vlerësonte në mënyrë periodike ecurinë e programit të studimit, cilësinë, stafin akademik të rekrutuar, literaturën në bibliotekë, rezultatet e arritura nga studentët, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtarinë kërkimore shkencore, dhe në fund paraqitej analiza SWOT dhe si masat e marra për përmirësimin në të ardhmen (A30, A34). Gjatë dy viteve të ekzistencës së programit MP në TDD, personeli Akademik dhe studentët ishin angazhuar kryesisht në përmirësimin e syllabuseve të lëndëve të vecanta. (A50, B15, A30).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në 'Teknika digjitale dentare' ishte departamenti i protetikës, i cili angazhohej në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme, planit të aktiviteteve të personelit Akademik dhe anketimeve të studentëve, në bashkëpunim edhe me NJSBC. (A51). Stafi Akademik dhe ndihmës i FTD ndiqte trajnime të organizuara nga Akademia me lektorë të zgjedhur nga institucionet partnere, si Akademia 3Shape apo Akademia Ivoclar, duke përmirësuar në këtë mënyrë mësimdhënien e tyre (B10). Aftësimi aftësimi didaktik i personelit ndihmës Akademik gjykohej shumë i rëndësishëm në formimin e studentëve të programit, ndaj kërkohej nga stafi akademik që ata së pari të prezantonin tema të ndryshme sipas syllabuseve në departament e më pas tek studentët, në trajnime dhe konferenca.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimi i dijeve dhe njohurive realizohen nëpërmjet leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, projekteve, praktikave profesionale dhe klinike, orëve të hapura, etj. Metodave të mësimdhënies realizohen në forma të ndryshme si interaktive dhe diskutime me në qëndër studentin, duke nxitur mendimin krijues, kritik, autonome dhe përgjegjshmërinë, pa mohuar metodat e reja inovative të mësimdhënies, falë trajnimit të vazhdueshëm të personelit akademik nga institucioni. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2


Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit të studentëve ishte një informacion që i jepej studentëve që në syllabusin e lëndës, dhe ju shpjegohej atyre në fillim të vitit akademik. Këto informacione dhe rregullorja ishin edhe të publikuara në faqen e internetit të AI (ivodent.edu.al). Vlerësimi i studentëve bëhej nëpërmjet kombinimit të një vlerësimi të vazhdueshëm të studentit përgjatë vitit akademik, me anë të punëve në laborator, si dhe një provimi përfundimtar. Studenti kishte detyrime semestrale dhe vjetore, të cilat duhet të shlyente e pas kësaj vlerësohej me një notë dhe fitonte kreditet respektive të parashikuara në syllabus. Vlerësimi kryesor bazohej në aftësimin praktik të studentëve, dhe monitorohej dhe përcaktohej nëpërmjet punimeve individuale që i caktoheshin studentit. (B11, B14, A53).</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të çdo viti Akademik, titullari i lëndës kishte detyrim të njihete studentin me syllabusin e lëndës duke i informuar ata në orën e parë të vitit akademik mbi përmbajtjen e lëndës, modulet, temat, ndarjen e orëve, mënyrën e vlerësimit, etj. Studentët vlerësoheshin në mënyrë konstante përgjatë gjithë vitit akademik, dhe merrnin një vlerësim me një testim në fund të procesit mësimor.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Studentët vlerësoheshin vazdimisht gjatë vitit në të gjitha lëndët, si nga njohuritë teorike, ashtu edhe ato praktike. Testimi gjatë një semestri ose viti Akademik realizohej përmes detyrave të kursit, projekteve, punëve laboratorike, provimeve të ndërmjetme dhe provimit përfundimtar. Mënyra e vlerësimit dhe shpërndarja e pikëve brenda lëndës/modulit bëhej sipas modelit të detajuar nga departamenti, por duke mbetur në kompetencë të titullarit në syllabusin e lëndës, i cili përcaktonte pikët për secilin komponent</p>


	të mësimdhënies (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratore dhe provim përfundimtar) (B14).			
Konkluzione	<i>Mënyra e testimit të vlerësimit të njohurive dhe dijeve janë përcaktuar qartë në rregulloren e programit të studimit, që bëhen publike dhe njihen nga studentët. Kjo u bëhet e qartë studentëve në fillim të lëndës/modulit. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në fillim të cdo viti Akademik, titullari i lëndës kishte detyrim të njihte studentin me syllabusin e lëndës duke i informuar ata në orën e parë të vitit akademik mbi përmbajtjen e lëndës, modulet, temat, ndarjen e orëve, mënyrën e vlerësimit, etj. Studentët vlerësoheshin në mënyrë konstante përgjate gjithë vitit akademik, dhe merrnin një vlerësim me një testim në fund të procesit mësimor. Programi i studimit kishte si objektiv kryesor përgatitjen praktike të studentëve, ku testimi bëhej me anë të projekteve individuale, ndërsa për sa i përket testimit të pjesës teorike, përdroeshin forma testimi si quize, etj. (B14)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Vlerësimi i njohurive teorike dhe praktike bëhej me anë të ngritjes së një komisioni vlerësimi, me qëllim edhe për të shmangur vlerësimin subjektiv. Institucioni kishte investuar në ndërtimin e një sistemi elektronik të brendshëm, ku studentët merrnin informacione si dhe komunikonin me stafin akademik. Në këtë platformë studentët logoheshin me të dhënat personale të marra në momentin e regjistrimit. Studentët në sistem kishin akses vetëm në të dhënat personale të provimeve ose testeve, si dhe në njoftimet dhe komunikimet e postuara nga sekretaria.

<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Raportet e vlerësimit përfundimtar të lëndëve/moduleve bëheshin në përputhje me syllabuset e cdo lënde dhe rregulloren e programit, rregulloren e përgjithshme dhe natyrën e lëndës/modulit të zhvilluar (A3, B11).</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Konsideruar numrin e vogël të studentëve në programin e studimit, komunikimi mes studentëve dhe pedagogëve arrinte të ishte i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë gjatë gjithë vitit. Kjo bënte të mundur që gjatë kryerjes së punimeve individuale, seminareve, laboratorëve studentët të asistoheshin, komentoheshin dhe ti jepeshin sugjerime mbi punën e kryer, në mënyrë që të përmirësoheshin vazhdimisht. Studentet që kishin nevojë për përmirësim ndiqeshin nga afër nga pedagogu i lëndës, i cili i këshillonte mbi mënyrat si mund të përmirësonin aftësitë praktike apo nivelin e të nxënit. (A53, A54).</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Provimet ishin organizuar në mënyrë që të shmangej kopjimi si dhe të evitohet vlerësimi subjektiv. Provimi me shkrim fillonte me hyrjen e studentit në salle, te cilit i jepej teza e provimit dhe pas dhënies së tezës, në salle nuk lejohej futja në provim e studentëve të tjerë. E gjithë procedura monitorohej nga anëtarët e komisionit që siguronin zhvillimin korrekt të provimit. Gjithashtu, sipas të dhënave të institucionit, gjatë provimit nuk lejohej hyrja e personave të jashtëm, përvec atyre të autorizuar me shkrim nga Dekani apo Rektori, apo drejtues të departamentit apo të fakultetit. (A7, A55, B11). Mjediset e provimit ishin të pajisura me sistem kamerash që bënte të lehtë monitorimin, si dhe trasparencën në rast kontestimesh nga studentët.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sistemi i vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale bazohej në një sistem me 10 nota, ku nota kaluese më e ulët ishte nota 5. Studenti kishte të drejtë të njihej me notën e vlerësimit, si dhe me komentet/feedback të dhënë nga pedagogu i lëndës. Rezultatet e provimit me gojë u bëheshin me dije studentëve në përfundim të provimit ndërsa të atyre me shkrim pas korrigjimit të tyre. Rezultatet paraprake të provimit hidheshin në sistem nga komisioni brenda ditës kur provimi zhvillohej me gojë, dhe brenda 5 ditësh (të punës) kur provimi zhvillohej me shkrim ose me shkrim dhe gojë. Në rastet kur provimi zhvillohej në formën e pyetjeve me përgjigje alternative, komisioni shpallte gjithashtu celësin e zgjidhjes. (A56, A57)</p>




<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Pas shpalljes së rezultateve paraprake (hedhjes në sistem) studenti kishte të drejtë të njëjët me tezën e provimit, pikët totale të vlerësimit si dhe pikët për cdo rubrikë. Nëse studenti konstatonte se kishte rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pa llogaritura në vlerësimin totale, ai kishte të drejtë të reklamonte provimin me kërkesë me shkrim, e cila depozitohej pranë sekretarisë brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve (A58).</p>			
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Në shumicën e rasteve problematikat e shtruara nga studentët lidhur me vlerësimin, ishin qartësuar nga komisioni i vlerësimit. Në rastet kur ishte e nevojshme, ngrihej një komision i posaçëm në përputhje me rregulloren e provimeve, i cili shqyrtonte dhe rikorigjonte provimin. (A58)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive realizohet përgjatë gjithë vitit akademik dhe në fund reflektohet në vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi jepet nëpërmjet sistemeve elektronike duke shmangur format e abuzimit dhe duke rritur transparencën. Njësitë përgjegjëse kanë punuar shumë për të shmangur plagjiatur si dhe kopjet e ndryshme në teste. Studentët kanë të drejtë të rishikojnë vlerësimin në përputhje me rregullat, statutin dhe procedurat e vlerësimit. Cdo ankimim shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit apo në raste të vecanta duke ngritur një komision të posaçshëm. Cdo dokumentacion arkivohet. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>




Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi MP ishte i organizuar në një kombinim lëndësh bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimeve përmbyllëse, të cilat në tërësinë e tyre synonin përgatitjen e profesionistëve të teknikave dentare, bazuar në eksperiencën e vendeve më të zhvilluara në fushën e dentistrisë. Plani mësimor i këtij programi kishte 13 lëndë, përfshirë praktikën profesionale dhe provimin përfundimtar, ku studenti thellonte njohuritë dhe zhvillonte aftësimin profesional e të vecantë në funksion të teknikave dentare. (B13)
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit, duke qënë se i përkiste fushës së shëndetësisë, fokusohej jo vetëm në aftësimin profesional të studentëve, por edhe në fitimin e njohurive të gjithanshme, përfshirë komunikimin dhe etikën profesionale të punës. (B17)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në përfundim të lëndës, pedagogët e moduleve realizonin një përmbyllje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synohej të arriheshin nga ana e studentëve në përfundim të modulit. Objektivat e vendosura diskutoheshin edhe me studentët të , duke marrë mendimet e tyre. Në javën e fundit të semestrit studentët orientoheshin në lidhje me çështjet e rëndësishme ku do të përqendrohej përgatitja e tyre për provimin final, strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do tëkësishte provimi si dhe peshën e notës së provimit në notën përfundimtare. (B14)

<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Infrastruktura laboratorike në AI ishte unike në teknikat digjitale në vend dhe shfrytë zonte aparatura dhe teknika të avancuara në fushën e teknikave dentare. Për module të caktuara, studentët testoheshin në laboratorët ku zhvillohej praktika, si laborator i protetikës fikse apo ai i teknikës digjitale. Gjatë laboratorëve studentëve u jepeshin detyra apo projekte kursi praktike, për të testuar njohuritë e marra dhe aftësitë e tyre. Gjatë këtyre detyrave ata mund të vendoseshin të punonin në mënyrë individuale ose organizoheshin të punonin në grupe prej 3-4 studentësh. Personeli Akademik mbështeste, orientonte dhe instruktonte grupin e studentëve në realizimin e detyrës së caktuar. Gjatë këtij procesi, personeli akademik mbështeste idetë inovative të studentëve në punimet praktike dhe identifikonte specifikat që kishin nevojë për më tepër informacion. Këto problematika bëheshin me pas objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në tema diplomash, etj (A15, A16, A30, A32).</p>		
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>FTD cdo vit ftone personel të ftuar nga universitetet partnere në kuadër të projekteve apo konferencave, të cilët zhvillonin leksione me studentët (B9). Gjatë këtyre leksioneve synohej dhënia e njohurive mbi të rejtat e fundit të shkencës dhe teknologjisë (A32).</p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Infrastruktura e AI dispononte mundësinë e zhvillimit të ideve dhe të mbështeste aplikimin e tyre edhe financiarisht nga personeli akademik dhe nga studentët (A7,A32). Personeli Akademik përfshinte studentët në projekte që ata kishin në zbatim si dhe kërkim shkencor. AI jepte gjithashtu mundësinë studentëve për mobilitet.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit krijon aftësi të vecanta në fushën e teknologjisë, informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit, jo vetëm në shqip por edhe në gjuhë të huaja. Institucioni gjithashtu nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve kërkimore të përparuara nga studentët dhe i mbështet ata financiarisht. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>



Standardi III.5**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Institucioni kishte hartuar procedura të detajuara lidhur me formën e organizimit të mbrojtjes së diplomës, e cila realizohej nëpërmjet një provimi përfundimtar sipas rregulloreve të përcaktuara nga programi i studimit dhe rregullorja e AI. Pasi studentët përmbyllnin me sukses provimin përfundimtar, dhe merrnin kreditet e përcaktuara nga programi i studimit, ata mund të diplomoheshin. (B11).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Institucioni ndiqte nga afër praktikën, projektet dhe përgatitjen për provimin përfundimtar (A59). Për provimin përfundimtar organizoheshin takime informuese për mënyrën e organizimit të tij. Zyra e shërbimit ndaj studentëve vinte në dispozicion manuale për përgatitjen e punimeve përfundimtare, njoftime në stendën e institucionit dhe në faqen zyrtare.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Sipas rregullores së programit të studimit, studentët pasi kishin përfunduar me sukses programin MP një vjeçar, mund të jepnin provimin përfundimtar, i cili i testonte për të gjitha modulet e zhvilluara gjatë vitit. Provimi përfundimtar zhvillohej kur studenti kishte shlyer detyrimet akademike. Përmbytja e provimit bazohej në njohuritë që studenti kishte marrë gjatë gjithë veprimtarive të zhvilluara. Provimi realizohej para një komisioni të vecantë të përbërë nga pedagogë efektive dhe të jashtëm. Kryetari i komisionit caktohej nga dekani dhe anëtarët e komisionit propozoheshin nga përgjegjësi i njesisë bazë dhe miratoheshin nga dekani. (A55, B11)
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Zyra e shërbimit ndaj studentëve vinte në dispozicion manuale për përgatitjen e punimeve përfundimtare, njoftime në stendën e institucionit dhe në faqen zyrtare. Institucioni ndiqte nga afër praktikën, projektet dhe përgatitjen për provimin përfundimtar. Për provimin përfundimtar organizoheshin takime informuese për mënyrën e organizimit të tij.




<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Infrastruktura laboratorike e AI ishte e mjaftueshme dhe mbulonte nevojat e programit të studimit. (A7).</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Organizimi i provimit bëhej në përputhje me rregulloret e programit të studimit, atë të përgjithshme, si dhe të sekretarisë mësimore. Studenti, pasi shlyente detyrimet akademike vjetore vlerësohej me notë duke fituar kreditet respektive.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Studentëve të vitit të fundit u vihej në dispozicion baza e pyetjeve të provimit përfundimtar. Në sesion provimesh studentëve u vihej në dispozicion me orare të zgjatura edhe biblioteka, laboratore, salla, etj. Organizimi i provimit bëhej në përputhje me rregulloret e programit të studimit atë të përgjithshme, si dhe të sekretarisë mësimore. Studenti shlyente detyrimet akademike vjetore dhe vlerësohej me notë duke fituar kreditet respektive. Me mbarimin e studimeve dhe shlyerjen e detyrimeve, studentët merrnin së bashku me diplomën edhe suplementin përkatës. (B21, A60).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Cdo student në regjistrimin fillestar pajisej me një numër personal matrikullimi. Sekretaria mësimore mbante regjistra bazë të studentëve me të dhënat personale, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë vitit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave të formatuara sipas akteve nënligjore në fuqi. Sekretaria mësimore gjithashtu arkivonte dokumentacionin e plotë të studentëve të diplomuar, si lista notash, etj. Regjistrat plotësoheshin në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbaheshin në ruajtje të përhershme. (A61).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Komisioni i posatshëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohurive të dhëna përgjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë gjithë lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. Personeli akademik/udhëheqes i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, shkrimin përfundimtar sipas udhëzimeve të miratuara. Në përfundim të provimit final ose të mbrojtjes të punimit të diplomës studenti vlerësohet me notë dhe pajiset me diplomë dhe suplementin e saj, të miratuara nga Ministria e Arsimit. Institucioni i ruan në përputhje me legjislacionin kopjen e dokumentacionit të studentit, dhe në rast se kërkohet i jepej atij pa asnjë pengesë. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6	
Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni dispononte ambiente të ndryshme për bibliotekë, senatin, salla audiovizive, salla kompjuterash, sallë konferencash, që mundësonin aplikimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe praktikës profesionale. Infrastruktura e AI dispononte mundësitë për aplikimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe organizimit të praktikave mësimore. Labororet dhe klasat ishin të pajisura me mjetet teknologjike, si komputera, internet, aparatura eudiovizive, mikroskope, kamera, monitorim, etj. (A7, B16).
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	GVJ vlerësoi 10 laboratorët që institucioni kishte në dispozicion, të cilët ishin të pajisur me teknologji bashkëkohore për kryerjen e orëve laboratorike dhe punëve individuale të studentëve. Punët laboratorike kryheshin në prani të pedagogut të lëndës dhe laborantit. Në shërbim të studentëve ishin edhe disponibël klinika dentare ku studentët mund të shihnin dhe zbatonin teknikat e mësuara në pacientë reale . (A7, A32, A62).
Kriteri 3. Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Cdo lëndë/modul zhvillonte praktika mësimore, klinike dhe stazhe në laboratorët e institucionit. Në rast se studentët duan ti bëjnë ato jashtë institucionit, bëhej e mundur njohja e tyre.
Konkluzione	<i>Institucioni garanton realizimin e praktikës laboratorike dhe profesionale në funksion të mësimdhënies. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X




IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Stafi akademik efektiv, ai me kontratë dhe personeli ndihmës kishin formimin dhe kualifikimin e duhur për përmbushjen me sukses të moduleve të përcaktuara dhe përmbushnin kriteret ligjore. Në programin MP angazhoheshin 1 staf Akademik me titull Profesor, 1 me titull Prof.Asoc, 1 Prof.Dr, 7 me titull Doktor dhe staf ndihmës 3 prej të cilëve me titull MSc. Personeli Akademik dhe ndihmës përditësonin njohuritë e tyre në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet specializimeve dhe trajnimeve në institucionet partnere (A65) dhe në akademitë e edukimit dentare pranë kompanive të zhvillimit të softwereve dhe aparaturave digjitale me të cilët AI kishte marrëveshje. Ata gjithashtu kishin akses në trajnime online dhe literaturë e materiale të vëna në dispozicion nga kompanitë 3Shape dhe Ivoclar MP në TDD përfaqësonte një fushë të re studimore e zhvilluar në vitet e fundit, teknikat digjitale dentare ishin futur për herë të parë në programet e studimit në Shqipëri nëpërmjet këtij masteri. (A13, B7, B8, B18, A23).</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Sipas marrëveshjes me MAS, personeli akademik efektiv përmbushte të paktën 70% të ngarkesës mësimore. (A23, B18).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Personeli Akademik efektiv ishte pjesë përbërëse e të tre njesive bazë të FTD dhe angazhohej prej shumë vitesh në mësimdhënie dhe programe të tjera që ofronte FTD (A63). Stafi Akademik me kontratë vinte kryesisht nga IAL me të cilët institucioni kishte marrëveshje bashkëpunimi (A6.1, A6.3, A6.4). Sipas detyrimeve ligjore, stafi kishte kontratë të rregullt pune me AI (A15, A16, A64, A65, A66). AI nga ana e saj kryente detyrimet financiare në mënyrë të rregullt dhe transparente (A67).</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i stafit Akademik përcaktohej nga rregullorja e fakultetit dhe ndiqte një procedurë të qartë. Shpalljet për pozicionet vakante publikoheshin në faqen zyrtare të internetit shoqëruar me kriteret e kërkuara si parakusht për kandidatin dhe kriteret që duhet të përmbushte në perspektivë. Kriteret e kërkuara përcaktoheshin nga administratori i AI. Rekrutimi bëhej bazuar në kritere si titujt akademike, statusit dhe ngarkesës mësimore sipas gradës shkencore. Përzgjedhja bëhej nga një komision sipas një procedurë transparente, duke vlerësuar dosjet e paraqitura dhe duke diskutuar kriteret e secilit kandidat. Cdo person i përcaktuar për tu punësuar lidhte më pas kontratën individuale të punës me institucionit, në respekt të kodit të punës. (A64, A65, A66, A10, A68)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Personeli ndihmës Akademik përbëhej nga 5 persona të përzgjedhur sipas karakteristikave të lëndëve dhe praktikave laboratorike që kryheshin në MP ne ‘Teknika digjitale dentare’. Personeli Akademik ndihmës kishin mbaruar studimet e ciklit të parë në teknika dentare dhe ishte përzgjedhur në bazë të njohurive lidhur me teknikat digjitale dentare si dhe eksperiences së punes në laboratorë të digjitalizuar dentare. Numri i tyre ishte i mjaftueshëm për realizimin e praktikave mësimore. (B9, A63, A69).</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni përditëson cdo vit Akademik organikën dhe shpërndarjen e detyrave në secilin prej pjestarëve të stafit Akademik, ndihmës Akademik dhe administrativ. Studentëve u prezantohej i gjithë stafi dhe rolet që ata mbulonin, si dhe mënyrat e kontaktit me ta. Stafi Akademik dhe ndihmës përcaktohej nëpërmjet shpërndarjes së lëndëve përgjatë semestrave, të dhëna që grupoheshin me aktivitete të tjera si pjesëmarrje në konferenca, publikime, etj. Departamenti mbante statistika mbi stafin Akademik ndërsa dosjet e tyre administroheshin nga sekretaria mësimore. (A63, B18, A70).</p>




<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni kishte bashkëpunim të vazhdueshëm me institucione partnere brenda dhe jashtë vendit. Ndër këto GVJ vlerësoi bashkëpunimin me Universitetin Politeknik të Tiranës, duke qënë se MP në ‘Teknika digjitale dentare’ përfaqësonte një fushë interdisiplinore në të cilën ndërthurej inxhenieria materiale dhe mekanike, informatika dhe dentistria, si dhe me partnerë të jashtëm, si 3Shape dhe Exocad. Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve dhe marrëveshjeve ofroheshin materiale, trajnime, literaturë, etj, të vazhdueshme për stafin Akademik dhe ndihmës. AI kishte gjithashtu bashkëpunime me klinika dentare dhe laboratorë dentare që i mundësonin studentëve të punonin edhe me pacientë reale. (A12, A13, A62, B9)</p>		
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritis që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktika profesionale konsiderohej e përfshirë në cdo lëndë në formën e praktikës mësimore që zhvillohej gjatë vitit, pasi ajo zhvillohej në mënyrë të vazhdueshme dhe në kushtet e laboratorëve të institucionit. Praktikrat zhvilloheshin edhe në bashkëpunim me klinika dentare dhe laboratorë që sillnin raste pacientësh reale (A12, A32, B13, A62).</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe personeli ndihmës akademik, angazhoheshin në realizimin e programit të studimit, duke arritur nivelin e duhur të kualifikimit akademik, në varësi të lëndëve dhe moduleve mësimore të programit. Personeli akademik efektiv ishte i mbuluar me ngarkesë mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Përzgjedhja e rekrutimit të personelit akademik bëhej në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike, në varësi të programit të studimit. Personeli ndihmës akademik realizonte orët laboratorike, mirëmbajtjen e laboratorëve dhe realizimin e praktikave profesionale apo laboratorëve, sipas programit të studimit. Në të ardhmen personeli akademik duhet të luftojë për rritjen e gradave shkencore dhe titujve akademikë. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	



Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Programi MP në TDD ishte i fokusuar në aftësimin e studentëve në përdorimin dhe aplikimin e teknikave digjitale, fushë e cila ishte kryesisht e fokusuar në aspektin praktik. Për këtë arsye AI kishte investuar rreth 200.000 Euro për infrastrukturën digjitale. Studentët studionin dhe praktikoheshin në teknologjinë digjitale dentare nëpërmjet aplikimit të Softëere 3Shape, Exocad dhe Maestro3D, Makineri Cad-Cam, Printer 3D, të cilat përfaqësojnë sisteme dhe softuere të cilat përdoren dhe preferohen në të gjitha vendet përëndimore, duke krijuar në këtë mënyrë mundësi dhe punësimin e studentëve jo vetëm brenda por edhe jashtë vendit. Numri i studentëve të pranuar në master ishte në përputhje me kapacitetet laboratorike të AI (A7, A32, A69, B13).</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni përveç hej nga 4 objekte të ndërtuara dhe rivlerësuara me materiale dhe teknologji bashkëkohore të dedikuara tërësisht administratës, veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. Rikonstruksioni i tyre ishte realizuar 2-3 vitet e fundit duke u fokusuar në parametrat higjieno-sanitare. GVJ vlerësoi se objektet e institucionit plotësonin të gjitha kushtet higjieno-sanitare. (A71). Shërbimet elektronike, magazinimi i të dhënave, klasat virtuale, etj, ofroheshin nëpërmjet platformës Google Education, e cila shfrytëzohej në Akademi që prej vitit 2020. Nga aspekti teknologjik TDD ishte i kompletuar me aparatura digjitale dhe mbulim informatik. (A32, A71, A72, A73).</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Veprimtaria e institucionit ishte e organizuar në 4 objekte të ndërtuara dhe rivlerësuara me materiale dhe teknologji bashkëkohore të dedikuara tërësisht administratës, veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore. Rikonstruksioni i tyre ishte realizuar 2-3 vitet e fundit duke u fokusuar në parametrat higjieno-sanitare. GVJ vlerësoi se objektet e institucionit plotësonin të gjitha kushtet higjieno-sanitare. (A71). Shërbimet elektronike, magazinimi i të dhënave, klasat virtuale, etj, ofroheshin nëpërmjet platformës Google Education, e cila shfrytëzohej në Akademi që prej vitit 2020. Nga aspekti teknologjik TDD ishte i kompletuar me aparatura digjitale dhe mbulim informatik. (A32, A71, A72, A73).</p>



<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni kishte në dispozicion të studentëve një hapësirë të përbashkët 12+1 vendesh pune për disenjimin e punimit dentar, ku mundësohej projektimi në TV dhe linja internet e shpejtë me fibër optike, si dhe një hapësirë në të cilën ndodhej pjesa e aparaturave prodhuese. (A7, A32)</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Akademia kishte kapacitetet e nevojshme e të kompletuara për të realizuar proceset e mësimdhënies. Ajo kishte dy hapësira të dedikuara për studim, disenjim dhe përpunim të punimeve dentare (printim 3D, Cad-Cam, printim me lazer, furra pjekje, etj). Studentët aktivizoheshin edhe me punime në pacientë reale, falë bashkëpunimit të Akademisë me klinika dentare dhe laboratorë dentare (A7, B14).</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni siguronte mjediset e mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve dhe në përputhje me natyrën specifike të programit. Mjediset mësimore ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, duke realizuar me sukses mësimdhënien, dhe për sa i përket orëve teorike, ashtu dhe praktikave profesionale dhe laboratorike. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="635 1339 817 1435">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="817 1339 1043 1435">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1043 1339 1246 1435">Përmbushet</th> <th data-bbox="1246 1339 1423 1435">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="635 1435 817 1500"></td> <td data-bbox="817 1435 1043 1500"></td> <td data-bbox="1043 1435 1246 1500"></td> <td data-bbox="1246 1435 1423 1500">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht						
			X						




Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Konsideruar se kjo fusha e studimit të masterit profesional në ‘Teknika digjitale dentare’ ishte një fushë e re, nuk ekzistonin akoma tekste të disponueshme në gjuhën shqip, por academia dispononte botime ndërkombëtare të cilat përditësoheshin duke u pasuruar dhe me literaturë interdisiplinore Institucioni ofronte tekste mësimore falas për studentët ku përfshihej edhe literatura plotësuese që studentët mund ta printonin pa kosto pranë sekretarisë mësimore. Personeli akademik vinte në dispozicion ciklet e leksioneve të miratuara paraprakisht dhe këto u ofroheshin studentëve nëpërmjet platformës online, nëpërmjet email, etj. (B14, A57, A75).
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Biblioteka pasurohej dhe përditësohej vazhdimisht me botime ndërkombëtare si dhe programe kompjuterike, manuale, protokolle dhe literaturë nga kompanitë zhvilluese të këtyre programeve, kryesisht në formë elektronike (A75).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në ambientet e bibliotekës studentët mund të aksesojnë literaturën në formë elektronike. Institucioni ishte i abonuar në Research4Life (ARDI, OARE, GOALI, HINARI, AGORA), të cilat ishin në dispozicion të studentëve nëpërmjet llogarive të tyre personale në sistemin elektronik ose në kompjuterat e bibliotekës. (A76, A77).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Databaza e botimeve ishte rritur mjaft prej kontributit të personelit Akademik, i cili vazhdimisht sillte materiale dhe botime shkencore në formë elektronike në institucion. Studentët plotësoheshin vazhdimisht me informacione shtesë, materiale didaktike multimediale që pedagogët dispononin nga aksesimi dhe kërkimi i tyre. Një nga kontributet kryesore nga marrëveshjet që AI kishte me institucionet, ishte aksesimi në bibliotekat që kishin këto institucione, si psh Biblioteka e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Biblioteka e Universitetit Aldent, Biblioteka e Universitetit Politeknik të Tiranës, etj (A6.1, A6.2, A6.3, A6.4, A6.6, A75)



<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Pedagogët dhe stafi ndihmës kujdesej që studentët të përditësoheshin dhe të përdornin të gjitha shërbimet e ofruara. Mjediset e shkollës ishin të aksesueshme me orare të zgjatura të parashikuara në programin mësimor. Institucioni ofronte shërbime mësimore kurrikulare dhe jashtë kurrikulare falas për studentët. Trajnimet, demonstrimet apo shërbime të tjera përfshirë materialet didaktike ishin në dispozicion të studentëve sipas kontratës së studentit dhe rregullores së bibliotekës. (A77, B13, B22).</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Institucioni investonte vazhdimisht në përmirësimin e infrastrukturës, përmirësimin e mjediseve tëpunës si dhe facilitetet për stafin dhe studentët, si dhe rritjen e kapaciteteve të informatizimit. Të gjitha mjediset e godinave ishin të mbuluara me sistemi E IFi. Disa salla pune dhe laboratorit informatik ishin në dispozicion me orare të zgjatura Salla e bibliotekës ishte e pajisur jo vetëm me tekste fizike por edhe me komputera, ku mund të aksesohet literatura elektronike. (A7, A75, A76, A77, A32).</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i bibliotekës dhe sallës së kompjuterave ishte ai zyrtar por me kërkesë të studentëve ose gjatë sesioneve të provimeve ato ishin funksionale me orare të zgjatura. Aksesit në libraritë online ishte pa limit gjatë gjithë vitit Akademik. (A77)</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni, Departamenti i protetikës dhe stafi akademik pasuronin vazhdimisht fondin e bibliotekës me botime të reja. Një kohësisht ishte investuar në platforma online ku studentët kishin hyrje të lirë nëpërmjet kompjuterave të bibliotekës për të aksesuar tekste dhe literaturë online. Stafi Akademik përditësohej në mënyrë të vazhdueshme për botime të reja, nëpërmjet konferencave, trajnimeve, edhe lidhur me pasurimin e bibliotekës, pasi masteri përfaqësoi një fushë të re studimore, dhe botimet në shqip ishin inekzistente, ndërsa ato ndërkombëtare të pakta por në shtim. (A26, A35, A36, A37, A38, A39).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në vlerësimet e kritereve perkatëse, mendojme se standarti permbushet plotësisht.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	<p>Proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave kryeshin mbi bazën e parimeve të konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Sekretaria mësimore ishte përgjegjëse për informacionin dhe dokumentacionin në institucion, bazuar në aktet rregullatore të institucionit dhe akte të tjera për funksionimin e arkivave</p> <p>Për shkak të pandemisë Covid-19 u zhvillua edhe pjesa e platformës së edukimit në distancë, me përdorimin e platformave online, duke marrë zyrërisht shërbimet e Google Education. Institucioni përdorte një sistem të centralizuar kur përdoruesit të logoheshin me të dhënat e tyre personale dhe mund të aksesonin informacione. (A78). (A79, A32, A80, A81).</p>



Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.

Akademia dispononte bazë të dhënash lidhur me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit, të dhënat personale, etj në përputhje me legjislacionin në fuqi. Dokumentacioni ruhej në letër dhe në version elektronik. Në këtë dokument përshkruheshin të gjitha modalitetet e ruajtjes, klasifikimi dhe dhënies së informacionit të dokumentave.

Informimi dhe regjistrimi i studentëve realizohej nga Sekretaria mësimore dhe shërbimit ndaj studentit. Informacionet mund të merreshin edhe online në faqen zyrtare, apo në broshurat informuese të programit të studimit. Cdo informacion i lëshuar nga sekretaria siglohej nga titullari i institucionit, njësitë ose Administratori. Cdo informacion, korrespondencë, veprimtari e lidhur me procesin mësimore, cdo akt administrativ, krahas përmbajtjes elektronike kishte edhe formëshkresore të protokolluar në zyrën e protokollit. Institucioni mund të lëshonte dokumente zyrtare në formën e vërtetimeve. Diplomat dhe suplementet shpërndaheshin vetëm në formë të shkruar dhe vetëm në një kopje. Në rregulloren e përgjithshme parashikoheshin në vecanti natyra, niveli, përmbajtja dhe rezultatet e studimeve që ishin kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fusha e punësimit


Institucioni siguronte menaxhimin e burimeve njerëzore nëpërmjet zyrës së financës dhe shërbimeve mbështetëse, pranë të cilës depozitohej nga punëmarrësi i gjithë dokumentacioni nëpërputhje me legjislacionin në fuqi, statutin e AI dhe rregulloren për arkivimin e dokumentacionit.

Gjatë vitit 2022 ishte zhvilluar 'Platforma e studentit', e cila aksesohet online nga cdo aparat smartphone nga studentët për profilet e tyre, ku njiheshin me listën e notave, detyrimeve financiare dhe shërbimet e tjera elektronike.

AI kishte aplikuar Nëntor 2022 për një fond pranë ADISA për asistencë në inkorporimin e programit të menaxhimit të centralizuar me standartet e përshtatura për IAL Q.Ëiki nga Aachen. Q.ëiki do të zëvendësonte gjithë strukturën e ngritur elektronike menaxheriale aktuale duke e kthyer në një portal të qëndrueshëm. Ky softuer kishte përqendrim në mbulonte detyrat e përditshmërisë së stafit Akademik, ndihmës dhe administrativ sipas metodologjisë Agile.

(A1, A3, A7, A78, A81, A82, A83, A84, B11).

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>AI pë rdorte platforma online, si shërbimet e GoogleEducation dhe softuerit 'Portali i Studentit' ku individë t logoheshin me të dhë nat personale dhe mund të aksesonin informacione të ndryshme, si dhe mund të komunikonin midis tyre apo me pedagogë t. Studentë t mund të merrnin informacione mbi lë ndë t, provimet, detyrat, njiheshin me listën e notave, detyrimeve financiare apo të komunikonin me pedagogë t pë r cë shtje të ndryshme. (A32, A73, B20).</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni kishte shërbime të dedikuara brenda platformës Google Education, ku ata imund të logoheshin me të dhënat personale dhe mund të aksesonin informacione të ndryshme, si dhe mund të komunikonin midis tyre apo me pedagogë tme. Kjo synonte të nxiste interaktivitetin, jo vetëm midis studentëve dhe pedagogëve, por edhe mes studentëve, si dhe studentëve dhe alumni për zhvillimin e cilësisë si dhe krijimin e rrjetit të bashkëpunimit profesional.</p> <p>Përmirësimi i sistemit online kishte lehtësuar kontaktin në kohë reale midis stafit administrativ dhe atij akademik, duke shmugur vonesa për shkak të komunikimeve verbale. Strukturat përgjegjëse të ngarkuara me administrimin e sistemit informacionit ishin: Zyra IT dhe Bordi i Administrimit (A30, A32, A80).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nëpërmjet Portalit të studentit apo platformës Google Education, tudentët mund të logoheshin në sistem kudo dhe në kohë reale duke aksesuar llogarinë e tyre personale apo informacione të tjera dhe njoftime. Të gjitha zyrat e AI ishin të detyruara të jepnin informacione të detajuara për institucionin duke ruajtur konfidencialitetin në çështje specifike. Pë rveca platformave online, institucioni përdorte gjithashtu platforma rrjetesh sociale dhe platforma komunikimi si Telegram, E hatsapp, Facebook, Instagram, etj. (A61, A78, A82, A91).</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Faqja e webit ivodent.edu.al përditësohej në mënyrë të vazhdueshme dhe të plotë, duke pasqyruar informacione të dedikuara secilit program studimi që ofronte Akademia. (B20)</p>




Konkluzione	Institucioni dispononte sistemin e menaxhimit duke patur informacionin përkatës të studentëve, që nga regjistrimi i tyre e deri në diplomim. Institucioni dispononte dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik dhe ndihmës, administrativ dhe partnerëve të angazhuar për realizimin e programit. Institucioni përdorte platforma të ndryshme elektronike për realizimin e një pjesë të mësimin online, dhe për komunikime të tjera si njoftime për studentët dhe stafin, si dhe mundësonin komunikimin midis studentëve dhe stafit akademik. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Menaxhimi financiar ishte rregulluar me rregullore të posacme dhe administrohej nga bordi i administrimit. AI cdo vit, pas analizës së vitit më parë, detajonte buxhetin për vitin në vijim dhe e miratonte atë në bordin e Administrimit dhe në Senat. Cdo vit realizoheshin raportimet financiare të cilat viheshin në dispozicion të Ministrisë së Arsimit sipas formatit të kërkuar prej tyre.</p> <p>Marrëdhëniet financiare ishin transparente kundrejt drejtuesve të AO dheorganeve tatimore e audituese në vend. AI cdo vit hartonte një plan buxhetor. Të gjitha marrëdhëniet financiare ishin transparente kundrejt shoqërisë financuese dhe institucioneve financiare në vend</p> <p>Krijimi dhe përdorimi i burimeve financiare në AI bëhej në bazë të një plani të hartuar nga shoqëria që mbështet institucionin, menaxhimi financiar dhe kontributet kryesore ishin mundësuar nga shoqëria themeluese, e cila kishte anëtare në bordin e administrimit. Kjo formë organizimi ishte konsultuar me përfaqësues të MAS.</p> <p>Akademia ishte pjese e Ivodent Shpk, e cila ishte përgjegjëse për performancën dhe qëndrueshmërinë financiare të institucionit, dhe siguronte ecurinë financiare në rast se AI nuk arrinte të gjeneronte të ardhura të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha shpenzimeve të saj.</p> <p>Ndërkohë, të ardhurat që akademia siguronte prej tarifave të studentëve apo donacioneve i vinte në dispozicion të akademisë.</p>



	(A17, A18, A23, A26, A63, A85, A86).
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Institucioni siguronte mjetet e nevojshme për zbatimin e politikave financiare, parashikuar në programin financiar. Institucioni merrte masa për sigurimin e financimit dhe mbështetjes financiare të nevojshme për procesin mësimor-shkencor, administrimin e institucionit dhe realizimin e programeve të studimit nëpërmjet vendimeve të organeve drejtuese, senatit dhe bordit të administrimit.</p> <p>AI kishte një strukturë të posacme që ushtronte dhe hartimin dhe zbatimin e buxhetit në nivel institucional. Ky proces niste nga njësitë bazë dhe menaxhohej nga bordi i administrimit. Administratori i akademisë raportonte në mënyrë periodike dhe përgatiste informacionet e kërkuara në lidhje me menaxhimin financiar. Pasqyrat financiare pasi miratoheshin edhe nga BA, dërgoheshin në zyrat e tatimeve dhe QKB ku publikoheshin. Në auditimin financiar jepeshin informacione lidhur me politikën dhe masën e tarifave që arketoheshin nga studentet. Këto të dhëna publikoheshin gjithashtu edhe në faqen e internetit të AI.</p> <p>Aktualisht situata financiare e AI paraqitej e qendrueshme, dhe bazuar në ecurinë e dy viteve të fundit, GVJ vlerësoi se situata dukej premtuese për të ardhmen.</p> <p>(A17, A18, A63, A85, A88)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Veprimtaria financiare e AI ishte objekt auditesh ligjore në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe kërkesave ndërkombëtare të auditimit financiar (A1). Raportet financiare diskutoheshin në mbledhje Senati të hapur, ku analizoheshin pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e lëshuara nga audituesi i pavarur. Këto miratoheshin me vendim të bordit të Administrimit dhe dërgoheshin në zyrat e tatimeve dhe QKB, të cilat më pas publikoheshin. Në raportin e auditit financiar jepeshin informacione lidhur me tarifën e studentëve, mënyrat dhe drejtimet e përdorimit të tyre. Kontrolli dhe auditimi i jashtëm për IAL publike dhe private realizohej nga Strukturat Shtetërore të MAS dhe Agjensia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL), akreditimet fillestare dhe riakreditimeve periodike (A90, B19).</p> <p>(A85, A87, A90, B19).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në çdo fillim të vitit të ri Akademik, secili Departament raportonte tek Dekani mbi realizimin e planit të buxhetit për vitin Akademik. Në këto mbledhje diskutoheshin edhe nevojat financiare të parashikuara që mund të shfaqeshin, në këtë mënyrë bëhej me prioritet rialokimi i fondeve sipas nevojave të departamenteve (A63, A89).</p>




<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njesisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni bazohej edhe në mbështetjen financiare të shoqërisë Ivodent Shpk, e cila kishte qëndruar garante për ecurinë dhe stabilitetin financiar të AI, kjo edhe pasi ky institucion ishte një institucion i vogël arsimor, ku numrat e studentëve kanë qënë jo më shumë se 90 në total, cka e bënte financiarisht jo të vetë menaxhueshme. (A69, A7, A89).</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni hartonte një raport financiar të kostove të njesisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të tij. Në këtë plan financimi përmbahej financimi i burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse, shpenzime për bibliotekën online, grantet vendase apo të huaja, të lidhura me realizimin dhe funksionimin e programit, si dhe projekte apo zëra të tjerë. Institucioni garantonte qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njesisë bazë, si dhe kapacitet të mjaftueshëm për ecurinë normale të këtyre programeve duke qënë se numri i studentëve është i vogël, mendojmë se për të garantuar mbulimin financiar dhe vazhdueshmërinë e programit, institucioni duhet të mbështetet në burime të jashtme për të siguruar ecurinë. Për këtë arsye, <i>GVJ mendon se ky standard përmbushet kryesisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Pranimi i studentëve fillonte me përcaktimin e kkuotave dhe rritereve nga Senati i Akademisë Ivodent, bazuar në kapacitetet infrastrukturore dhe akademike që departamenti ofrues kishte në dispozicion. MAS kryente verifikimet e kapaciteteve para fillimit të cdo viti Akademik për të vlerësuar nëse institucioni kishte kushtet e duhura logjistike, pra infrastrukturë, staf Akademik, etj. Si kriter për t'u pranuar në këtë program, studenti duhet të kishte përfunduar me sukses një studim të ciklit të parë si Bachelor apo Master në teknika dentare, stomatologji apo programe të ngjashme. Lista e kandidatëve shpallej në web dhe në ambientet e akademisë. Në përfundim të procesit të regjistrimit studentët pajiseshin me një numër personal matricullimi në QSHA. Në regjistrimin e studentëve në program ndiqeshin udhëzime të MAS dhe vendime të Këshillit të Ministrave. Institucioni kishte hartuar dhe zbatonte politika dhe procedura që mbulonin në menyre të plotë periudhën e studimit nëprogramin MP në 'Teknika Digjitale Dentare' në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e institucionit dhe programit të studimit.</p> <p>Në nisjen e studimeve studentët njiheshin me rregulloren e programit, ambientet ku do të zhvillohej procesi mësimor si dhe pajiseshin me kartën e studentit. Në fillim të secilës lëndë studenti njihej me syllabusin dhe literaturën bazë e të rekomanduar nga secili pedagog. Kontrolli i mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit mësimor bëhej nga NJSBC. Gjatë viti akademik studenti vlë resohej në mënyrë kostante dhe në fund të programit të studimit duhet të akumulonte 60 kredite në mënyrë që të kisthte të drejtë në të diplomuar. Studentët diplomoheshin në fund me provim të përgjithshëm përfundimtar. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohej diploma Master Profesional 'Teknika Digjitale Dentare', pas miratimit të formatit të diplomës nga QSHA.</p> <p>(A3, A10, B11, A92, A93, A24, A8, A7, B1, B13, B21, A92, A93).</p>



<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pjese e organikës së institucionit ishte edhe Këshilli i Etikës, i cili garantonte të drejtat e parashikuara në Rregulloren e kodit të etikës për studentët dhe stafin institucional. Mos zbatimi i kësaj rregulloreje shoqërohej me pasoja për palën fajtoare, sipas parashikimeve në rregulloret e sipërpërmendura Rregullorja e MP në TDD përmbante në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikatat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi e deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre gjë që garantonte qartë politikatat dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit. (A10, B14, A94, B22).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Para fillimit të vitit Akademik institucioni publikonte kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, shoqëruar me kuotat e pranimit në programin MP në TDD dhe i bënte ato publike në faqen zyrtare dhe ambientet e institucionit. Pranimi i kandidatëve bëhej në mbështetje të kapaciteteve dhe kuotave të miratuara nga Senati dhe Bordi i Administrimit të AI. Pas miratimit Brenda institucionit, MAS ngrinte një grup pune i cili verifikonte kapacitetet pritëse të AI dhe bënte më pas përcaktimin e kuotave. Në rregulloren e programit përcaktoheshin kriteret e përgjithshme të pranimit dhe përzgjedhjes për çdo vit Akademik; sipas kritereve kishte të drejtë të kandidonte në Ciklin e Dytë të studimeve në FTD cdo shtetas shqiptar që kishte përfunduar me sukses së paku një diplomë Bachelor apo shtetas të huaj të cilët kishin kaluar me sukses provimin e njohjes së gjuhës shqipe dhe konvertuar diplomën universitare. Kandidatët duhet të kishin formimin bazë të teknikut dentar ose të fushave tjetra të ngjashme të shëndetit oral. (A92, A93, A8, A10, A24, B14).</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit dhe përparimit të studimeve të studentëve, transferimit nga një program studimi tjetër, njohjes së studimeve të kryera në një program tjetër të plotë ose pjesshëm apo dhe të realizuar në kuadër të projekteve të shkëmbimit Erasmus apo programe të tjera përcaktoheshin në rregulloren e fakultetit. (A10, B14). Këto informacione ishin të paraqitura për publikun dhe të interesuarit në faqen zyrtare të akademisë ose pranë Sekretarisë Mësimore fizikisht (A91).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Studentët asistoheshin nga sekretaria mësimore dhe zyra e mbështetjes të studentit. Në faqen zyrtare të akademisë, të interesuarit mund të informoheshin mbi programin e studimit, kriteret e pranimit, kohëzgjatjen e programit, tarifat, etj. AI vinte në dispozicion të studentëve materiale informuese, si broshura të cilat përditësoheshin në mënyrë periodike</p>



	(A74, A61).						
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.	Akademia, para fillimit të vitit Akademik përcaktonte kriteret e përgjithshme dhe të vecanta shoqëruar me kuotat përkatëse për çdo program studimi të ofruar. Sipas kriterëve kishte të drejtë të kandidonte në Ciklin e Dytë të studimeve në FTD çdo shtetas shqiptar që kishte përfunduar me sukses së paku një diplomë Bachelor apo shtetas të huaj të cilët kishin kaluar me sukses provimin e njohjes së gjuhës shqipe dhe konvertuar diplomën universitare. Kandidatët duhet të kishin formimin bazë të teknikut dentar ose të fushave të tjera të ngjashme të shëndetit oral. (A92, A93).						
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Institucioni ndiqte politika lehtësuese për studentët duke patur parasysh origjinën e tyre sociale. AI i kushtonte rëndësi të vazhdueshme kategorive sociale duke manovruar me bursat e ndryshme sipas situatës ekonomike (B11, B22). Kryesisht institucioni suportonte studentët me aftësi të kufizuara, komunitetin rom dhe egjiptian sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kjo e shprehur jo vetëm në aspektin e mësimnxënies, por edhe të veprimtarive të tjera social kulturore.						
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	AI përpiquej të zbatonte programin e ekselencës si dhe bursat për studentët me probleme sociale, edhe pse një institucion me mundësi financiare të limituara, për shkak të numrit të vogël të studentëve. (A7)						
Konkluzione	Institucioni hartonte politika dhe procedura që mbulonin ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet rregullatore. Institucioni hartonte dhe publikonte para çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhje dhe kriteret e kandidatëve për pranimin në programin e studimit, duke bashkëpunuar me maturën shtetërore sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Gjithashtu institucioni ofronte ndihma ekonomike ose bursa për shtresat në nevojë, por duke qenë një institucion i vogël shpesh duhet të bazohet financiarisht nga burime të jashtme. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>AI nëpërmjet portalit të studentit realizonte procedurën e pranimit të tstudentë ve duke siguruar transparence në lidhje me përparimin akademik të karrierës së tij (A91, A78, A82). Studenti në momentin e regjistrimit në program pajisej me një adresë emaili zyrtar nëpërmjet të cilës mund të aksesonte portalin e studentit (https://ivodent.edu.al/student) i cili mundësonte një pasqyrë të arritjeve akademike. Krahas portalit studenti mund ti drejtohej sekretarisë mësimore dhe Zyrës së Mbështetjes ndaj Studentit, duke krijuar mundësi studentit të kontrollonte vlerësimin, si dhe të merrte shërbime të tjera si regjistrime në provim, listë notash, vërtetime, etj. (B11, B14, B13, A91).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit MP në ‘Teknika digjitale Dentare’ përcaktoheshin qartë kushtet që duhet të plotësonin studentët për të kaluar nga një vit akademik në tjetrin, si dhe kriteret e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesëshme. Kë to informacione i bë heshin me dije studentë ve. Rregullorja e programit të studimit ishte e aksesueshme në faqen zyrtare të AI ose në format hardcopy në bibliotekën e AI. Paqartësitë apo informacione shtesë mund të merreshin nga studenti në rrugë elektronike ose drejtpërdrejtë në Sekretarinë Mësimore të shërbimeve ndaj studentit (A11, A98)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Cdo pedagog në fillim të semestrit kishtë pë rgjegjë sinë të njëjthe studentët me syllabusin e lëndës, mënyrat e vlerësimit për të gjitha lëndët përbërëse të programit. Syllabusi i lë ndë s, rregullorja e Fakultetit dhe rregullorja e programit të studimit, përcaktonin qartësisht procedurat dhe kriteret e vlerësimit të studentëve, duke pë rfshirë sistemin e vlerësimit, mënyrat e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimi i tyre si dhe ankimimet e studentëve. (A10, B11, B14).</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studentet e AI informoheshin për procedurën e provimit përfundimtar, mënyrat e përgatitjes dhe vlerësimit të këtij provimi nga departamenti, sekretaria më simore dhe vetë pedagogët. Në strukturën akademike të aprovuar nga rektori parashikohej data dhe periudha e punimit të diplomës për këtë program studimi. Studentët lajmëroheshin edhe nëpërmjet postës elektronike nga Sekretaria. (A10, B13, B14, A99).</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Mbështetjes ndaj Studentëve u siguron studentëve informacionet e duhura në raport me institucionin dhe detaje të programit të studimit. Procesi nisej nga MAS, ndërkohë dikur iniciohej nga institucioni. Në këtë proces përcaktoheshin: periudha e informimit, përfaqësuesi i AL, etj. AI nxirrte urdhërin përkatës ku detajoheshin datat, përbërja e grupeve të punës, qytetet dhe shkollat ku do të kryhej informimi. Sesionet këshillimore ishin një ekip i përzgjedhur me kujdes për të përcuar informacionin tek maturantët e gjimnazeve në qytete kryesore të Shqipërisë, pa përjashtuar edhe qytetet kryesore shqipfolëse të Rep. Kosovës dhe Serbisë. Ekipi përbëhej nga staf akademik i brendshëm i ndarë në grupe pune, i cili informonte studentët e ardhshëm mbi: Programet e studimit që ofroheshin nga akademia, si dhe të dhëna mbi kohë zgjatjen e programeve të studimit, licensimin dhe mënyrën e akreditimit të programeve, apo kriteret mbi pranimin në institucion, formularin e aplikimit, mbi sistemin e Bolognas dhe kreditet, stafin akademik dhe titujt e tyre, lëndët dhe kreditet e secilës, secili program studimi i ndarë në vitemundësitë që ofronte specializimi në teknika digjitale dentare brenda dhe jashtë Shqipërisë, gjendjen aktuale dhe parashikimet mbi trendin e punësimit të këtyre specialistëve, informacion mbi infrastrukturën e institucionit, mjediset, labororet, klinikat, praktikat e studentëve në këto laboratore, auditore, biblioteka dhe salla audiovizive si dhe informimi mbi kushtet fizike të akademisë, të dhëna mbi organizimin e praktikave në institucionet më të cilët AI kishte marrëveshje, si qendra shëndetësore shtetërore dhe private informacion mbi leksione dhe ëorkshope që zhvilloheshin me lektorë të kompanive partnere si Ivoclar Vivadent, BEGO, Rhein 83, Renfert, etj.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni vinte në dispozicion informacionin e plotë lidhur me kriteret dhe përparimet akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin, si dhe kriteret apo procedurat e realizimit të diplomës në përfundim të programit të studimit. <i>për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>




Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X


Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	AI vinte në dispozicion të studentëve në përmjet sekretaries më simore dhe faqes web të gjithë informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit që ofronte, strukturën, kohëzgjatjen, tarifat, etj. (https://ivodent.edu.al/master). Këto informacione mund të merreshin edhe në hardcopy pranë bibliotekës së AI. Gjatë javës së parë të vitit akademik studentëve u jepej gjithë informacioni dhe shpjegimi i detajuar mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatja, sesionet e provimeve, mënyrat e vlerësimit. (A74, B14, A91)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët pajiseshin që në javën e parë të studimeve me informacionet e duhura si broshura, tutoriale, video virtual, etj (A74, B20). Në momentin e regjistrimit studentëve u jepej informacion për mundësinë e punësimit pas diplomimit, akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit që ofroheshin, si dhe njohjen dhe vlefshmërinë e programeve dhe diplomës brenda dhe jashtë vendit. (A19, A74, B17, B20).
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Punësimi i studentëve në akademi dhe struktura të shoqërisë ishte një mundësi reale për çdo student. Akademia ofronte mundësinë e punësimit në pozicione të ndryshme me orare të limituara. Për studentët me rezultate të mira ajo ofronte mundësi punësimi në laboratorët dhe shërbimet që ofronte kompania Ivoclar. AI kishte eksperiencë të mire lidhur me punësimin e studentëve të diplomuar, ku në programet e mëparshme një pjesë e madhe e studentëve rezultojnë të punësuar, kjo për faktin se institucioni kishte krijuar një profil të përgatitjes së studentëve nga ana profesionale, si dhe një rrjet të gjërë bashkëpunëtorësh brenda dhe jashtë vendit, AI bashkëpunonte me tregun gjerman dhe punësimi i teknikëve në zonën




	gjerman folëse bëhej i mundur. AI kishte dhe një marrëveshje me kompaninë BBË me qendër në Lahstein, Gjermani. (A19, B17, A67)			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Njohja e studentëve me institucionin, infrastrukturën, asetet dhe shërbimet, sigurohej që në fillim të vitit (A7, A32). Në fillim të cdo moduli studenti njihej me syllabusin, punime praktike, oraret, infrastrukturën, stafin, rregullat e sigurisë, etj. Kjo siguronte mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe realizimin e objektivave të modulit përkatës (A17, A18).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Në momentin e regjistrimit studentët pajiseshin me emailin zyrtar të akademisë i cili shërbente për të lehtësuar dhënien e informacionit, për cdo komunikim të brendshëm, komunikim në distancë me pedagogët, për aksesin në portal, apo informim mbi çështje të caktuara. (A78, A82). Me anë të platformës Google Classroom krijoheshin klasat virtuale ku postoheshin materiale didaktike mësimore dhe zgjerimit të mëtejshëm të njohurive të studentëve. Gjatë sesionit të provimeve studentët aksesonin në portalin e studentit me anë të emailit të tyre zyrtar dhe shikonin në kohë reale notën e marrë. Akademia kishte edhe kanalin zyrtar në youtube, ku postoheshin video të regjistruara nga pedagogët gjatë leksioneve dhe laboratorëve (A91, B20).			
Konkluzione	Studentët informoheshin nga institucioni në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, gjithashtu ata informoheshin mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale drejt tregut të punës. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X




Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria më simore mbante të dhënat të organizuara në regjistra themeltarë, dosje të studentëve, në të cilat pasqyroheshin gjeneralitetet e tyre, numrat e martikullimit, format e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme dhe ecuria e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, punimet e dorëzuara gjatë periudhës së studimeve, vlerësimet e tyre gjatë kohës së studimeve, regjistrat e notave, fletë provimet, etj. Sekretaria Mësimore si strukturë përgjegjëse për nxjerrjen e statistikave mbi studentët, i kishin këto të dhëna vjetore ose ndër vite, sipas kërkesave të institucionit dhe institucioneve të tjera (QSHA, MAS, ASCAL, etj) (B17, A69, A101, A102, A103, A18, A81, A56, A58, A69)</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Përmes Sekretarisë Mësimore dhe Zyrës për mbështetjen e Studentit, AIdisponontedosje të studentëve, në të cilat pasqyroheshin gjeneralitetet e tyre, numrat e martikullimit, format e studimeve, të dhëna për studimet e mëparshme dhe ecuria e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim, si dhe dispononte të dhëna statistikore mbi numrin e studentëve, etj. (A102, A103, A104)</p>



<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Institucioni kishte komisionuar gjatë vitit 2022 krijimin e softuerit të quajtur "Portali i Studentit", ku stafi akademik kishte akses për të ngarkuar të dhënat përfundimtare dhe për të gjeneruar procesverbalet e sezonit të provimeve. Studentët kishin akses të personalizuar në këtë portal për tu futur në cdo kohë nga cdo pajisje, dhe ku mund të njiheshin me detyrimet financiare, notat apo të merrnin shërbime nga AI, si platforma Google Education. Institucioni gjatë vitit 2022 kishte filluar negociatat për marrjen dhe aplikimin e softverit. Qwiki si sistem i brendshëm i menaxhimit nëpërmjet metodave Agile dhe me përfshirje të standarteve të institucioneve të arsimit të lartë. Me aplikimin e Qwiki do të zëvendësoheshin gjithë platformat e tjera paralele dhe administrimi do të bëhej prej secilit të stafit sipas detyrave përkatëse. Proceset e përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale të studentëve kryheshin bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, rregulloret e brendshme të AI, dhe arkivoheshin sipas procedurave të specifikuara në rregulloren e arkivës. Mirëmbajtja e të dhënave dhe administrimi realizohej nga Sekretaria Mësimore me asistencën e departamentit të IT stafi trajnohej në vazhdimësi për menaxhimin korrekt dhe konfidencial të të dhënave si dhe praktikave për ruajtjen e të dhënave personale (A10, A81, A78, A79, A80, A82, A83, A84).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e institucionit, sekretaria mësimore dhe NJSBC kontrollonte dokumentacionin përkatës si dhe ruajtjen e të dhënave personale. Rregulloret e mësipërme bazoheshin në ligjet për arkivat dhe ligjet për mbrojtjen personale, si dhe në rregulloren e arkivës së AI. Dekanati i FTD ushtronte kontrole periodike mbi saktësinë e informacionit dhe nëpërmjet kartës së studentit që kryhej pranë Bashkisë Tiranë cdo vit. Duke qënë se AI ishte një institucion i vogël, kjo krijonte lehtësi në menaxhimin dhe monitorimin në mënyrë të vazhdueshme. Pjesë e vlerësimit ishin dhe auditet e jashtme që institucioni organizonte në mënyrë të përvitshme. (A85, A105, A106, A3, A61, A81, A97, A17, A18).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti i protetikës vlerësonte cdo fillim viti cilësinë e rekrutimit të studentëve në dy programet e tij. Vlerësimi bëhej duke u bazuar në mesataren e shkollës së mesme apo studimit të mëparshëm por edhe në shpërndarjen gjeografike dhe përgjigjet e anketimeve të studentëve të mëparshëm mbi arsyet e zgjidhjes dhe kënaqësitë në fillim të vitit. Meqë numri i studentëve në këtë program ishte i vogël (9 studente të punësuar 100%) dokumentimi dhe diskutimi i cilësisë së punësimit të tyre ishte i thjeshtë. Ato ishin të punësuar në qendra të teknologjisë digjitale dentare shqiptare dhe në gjermani, si dhe kërkesa për punësim të tyre ishte në rritje. (A108).</p>




Konkluzione	Institucioni dispononte dhe mbante statistika vjetore mbi numrin e studentëve dhe të diplomuarve, si dhe për studentët që tërhiqeshin nga programi apo ata që nuk përfundonin me sukses vitin akademik, të dhëna të cilat aksesoheshin dhe verifikoheshin lehtësisht nga persona të autorizuar. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht .		
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni inkurajonte pjesëmarrjen e studentëve në vendimarrje, organizimin e lirë të tyre dhe shprehjen e mendimit të tyre të lirë, e shprehur kjo në statutin e AI. Studentët ishin të organizuar në këshillin studentor duke patur hapësirën për të qënë pjesë integrale e institucionit. Këshilli studentor ishte organizëm i pavarur dhe merrej vetëm me problematikat e institucionit. Ky promovonte pjesëmarrjen e studentëve, përfaqësimin në organe drejtuese, etj. (A1, A109, A63, A1, A109).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Akademia përdorte mekanizma të drejtpërdrejta komunikimi dhe informimi me studentët, dhe siguronte komunikim ndërmjet tyre dhe personelit akademik. Këshilli studentor shprehte mendime dhe propozime për probleme të ndryshme në interes të institucionit, si dhe të vetë studentëve. Studentët në bashkëpunim me NJSBC merrnin pjesë në grupet e punës në vlerësimin e cilësisë. (A3, A109, A110).

<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Institucioni kishte krijuar databazën e alumni dhe mbante lidhje me ta, duke ofruar mundësinë e mbështetjes dhe përkrahjes së tyre dhe pas mbarimit të studimeve, si dhe të atyre që do të vazhdonin studime të mëtejshme në AI. Institucioni kishte punësuar një student të diplomuar në programin e studimit gjë që ndikonte në përmirësimin e programit në varësi të sugjerimeve të tij. (A67, A111, B11).</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Ky institucion në qendër kishte studentin duke i njohur ato që ne ditët e para, falë edhe numrit të vogël të tyre, duke zgjidhur kështu edhe problematikat që mund të prezantoheshin gjatë vitit akademik. Ky relacion ndihmonte në krijimin e një fryme besimi reciprok, që reflektohej edhe në testime, provime, ku studentët rrallë herë kontestonin rezultatin e marrë në testime apo provime.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni përfshinte studentët në organet vendimarrëse sipas akteve ligjore në fuqi, të cilet reflektonin sugjerime dhe mendime në mbledhjet e përbashkëta të departamentit apo njësise bazë. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>




Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni pë rmbante pë rvec sekretarisë mësimore, edhe zyrat e. Kë to së bashku luanin rolin e strukturave përgjegjëse që orientonin dhe ndihmonin studentët në marrjen e informacionit të nevojshëm mbi programet e studimit. Zyra e mbështetjes së studentëve orientonte gjithashtu studentët për të gjetur hapësirën në tregun e punës, për mënyrat si të bënin aplikime të efektshme dhe si të përmbushnin kriteret e punëdhënësve (A63, A61).
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Institucioni kishte investuar për krijimin e platformë s digjitale, që shërbente si burim komunikimi dhe informacioni për studentët dhe stafin akademik. Studentët aksesonin në platformë nëpërmjet adresës personale elektronike dhe mund të logoheshin në domainin e institucionit (emer.mbiemer@ivodent.edu.al) me të cilën pajiseshin në momentin e regjistrimit, mund të logoheshin në portal ku gjenin informacionet mbi ecurinë tyre akademike. Përmes platformës Google ishin krijuar Google Classrooms ku studentët informoheshin mbi procesin mësimor, materiale, detyra, etj. Aty studentët njiheshin me njoftime, trajnime, uorkshope, njoftime të dërguara nga sekretaria, pedagogu i lëndës, apo struktura drejtuese të AI. Një nga avantazhet e AI ishte vëmendja ndaj punësimit të studentëve, që shihej që në ditët e paratë regjistrimit, edhe falë bashkëpunimit me kompani apo biznese të fushës përkatëse. Na të dhënat e institucioni vlerësohej se një pjesë e madhe e studentë ve merrnin oferta Pune ose arrinin të punësoheshin pa mbaruar ciklin e studimeve.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra mësimore, sëbashku me zyrën e Karrierës kishin statistika të rregullta mbi numrin e studentëve të diplomuar, vendin e punës, karakteristikat e punës, kohë n kur ishin punë suar, konsideruar se një pjesë e tyre kishin arritur të punësoheshin akoma pa mbaruar programin e studimeve, etj. (A69, A119, A13, A14).


<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>AI kishte ndjekur politika favorizuese të punësimit edhe brenda institucionit. Punësimi i studentëve në AI dhe struktura ishte mundësi reale, gjithashtu si për punësim me kohëtë plotë ashtu dhe të pjesëshme.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni kishte njësi të posaçshme për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve, në përputhje me aktet ligjore dhe ato të institucionit, si për sa i përket procesit mësimor, ashtu dhe programit të studimit. Institucioni kishte zyrën e këshillimit të karrierës, e cila mirëpriste studentët periodikisht dhe i këshillonte ata, si dhe i ndiqte gjatë procesit pas diplomimit duke marrë në konsideratë punësimin e mëvonshëm. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	--




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Infrastruktura aktuale që AI dispononte aplikimin e të gjithë elementeve të nevojshëm mësimorë, didaktik, studimor si dhe realizimin e praktikave profesionale. Si infrastruktura fizike, ashtu dhe ajo digjitale, funksiononte më së miri pasi stafi ishte i trainuar për një përdorim adekuat të tyre. Ambientet për zhvillimin e mësimin si klasat, laboratore ishin të pajisura me mjete të nevojshme teknologjike në varësi të degëve të ndryshme, kishte ambient të bollshëm për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, salla kompiuterash, sallë për konferenca, të cilat mendojmë se ishin të mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor dhe praktikave mësimore. Gjatë kohës së pandemisë Covid 19, akademia i kishte marrë shërbimet e platformës Google Education nëpërmjet të cilave vazhdonte edhe më sot t'i përdorte për të rritur më tej komunikimin midis stafit dhe studentëve, por edhe si mënyrë për të shkëmbyer prezantimet e materialeve didaktike multimediale. Personeli gëzonte lirinë akademike për të vënë në zbatim shembujt, ide të reja inovative të mësimdhënies duke sjellë eksperiencat në varësi të institucioneve partnere (A7, A32, A73, A79, A112, B16)</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Për realizimin e cilësisë së mësimdhënies, institucioni kontrollon të brendshme dhe të jashtme. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe institucioni hartonin kontrollon dhe anketime të vazhdueshme me studentët dhe stafin akademik të angazhuar në procesin mësimor. Për sa i përket kontrolleve të jashtme për sigurimin e cilësisë, institucioni kishte lidhur marrëveshje me IQE, e cila bënte anketime dhe pyetësorë të vazhdueshëm me studentët. Të dhënat e nxjerra nga këto kontrolle, si pikat e forta apo të dobëta, dhe anketimet I përcilleshin departamenteve përkatëse në mënyrë që të azhurnoheshin me to dhe të përmirësonin cilësinë në të ardhmen (A50, A97, A47, A34, A46, A47, A48).</p>




<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>NJSBC mblidhte anketime të vazhdueshme nga studentët nëpërmjet kanaleve anonime digjitale (nëpërmjet një emaili të dedikuar) dhe nëpërmjet komunikimit me këshillin studentor. NJSBC nëpërmjet vlerësimit të saj merrte rezultatet nga mësimdhënia si dhe ndonjë pakënaqësi eventuale për ta evidentuar dhe përmirësuar atë. (A34, A91, A109)</p>			
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>NJSBC mblidhte anketime të vazhdueshme nga studentët nëpërmjet kanaleve anonime digjitale dhe nëpërmjet komunikimit me këshillin studentor. Rezultatet e anketave dhe pyetësorëve bëheshin publike në forma të dhënash për studentët në stendat informuese si dhe në mënyrë digjitale. Gjithashtu realizohej edhe një analizë e gjerë me departamentet dhe dekanatin (A50, A30).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni gjatë 3 viteve të fundit kishte qenë objekt i vlerësimit në kuadër të akreditimit institucional dhe programit të teknikave dentare. Këto procese kishin ndihmuar institucionin të konsolidohej më tej si dhe kishin shërbyer për të konsoliduar mekanizmat e brendshme të cilësisë duke përmirësuar zhvillimin e mësimdhënies me qëllim krijimin e profesionistit të teknikut dentar sipas standarteve perëndimore. (A50, A114, A115).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni hartonte udhëzues të posaçëm për përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies në bazë të fushës studimore. Strukturat përgjegjëse kishin mekanizma që monitornin dhe vlerësonin këto procese. Institucioni promovonte shembuj dhe praktikat më të mira duke nxitur personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	
			<p>X</p>	




Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Institucioni ishte përgjegjës për sigurimin e cilësisë, dhe kjo pasqyrohej në Njesinë NJSBC, struktura dhe funksionimi i të cilës përcaktohej në statutin e institucionit përkatës. NJSBC përfaqësonte strukturë përgjegjëse të angazhuar në kontrollin e sigurimit të brendshëm të cilësisë duke hartuar procedura dhe politika për përmirësimin e cilësisë. Në planin afatshkurtër të zhvillimit synimi kryesor ishte garantimi i cilësisë së mësimdhënies në përputhje me standartet shtetërore dhe kodin e cilësisë. Përgjatë çdo viti akademik institucioni vlerësonte performancën e personelit, atij akademik dhe ndihmës akademik, jo vetëm në aspektin e mësimdhënies por edhe të kërkimit shkencor, kualifikimit dhe kontributit intelektual, në varësi të analizave të detajuara për vitet paraardhëse. (A1, A2, A17, A18, A63).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Në AI funksiononte njësi NJSBC, e cila rregullohej nga statuti i saj dhe rregullorja e institucionit, duke patur në fokus monitorimin, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. NJSBC bashkëpunonte me njësitë tjera akademike, administrative dhe studentore bashkëpunuese duke siguruar kontrollin e cilësisë së brendshme në institucion. Për sa i përket kontroleve të jashtme, institucioni kishte një marrëveshje me Institutin për Cilësi dhe Edukim (iqe.al) e cila në mënyrë të vazhdueshme zhvillonte analiza nëpërmjet anketave dhe pyetsoreve me studentët. (A1, A2, A46, A97, A63)</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni kishte në fokus plotësimin e standarteve shtetërore dhe raportet e vlerësimit të jashtëm, si dhe bashkëpunimi me ASCAL, ndihmonin në përmirësimin e performancës së vet në tregues të ndryshëm të cilësisë. Programet e studimit që ofronte AI, monitoroheshin vazhdimisht nga NJSBC, përcjellë kjo edhe nëpërmjet kontaktit me studentët, duke siguruar monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë pavarësisht përmasave të vogla të institucionit. Gjithashtu institucioni mbantë kontakte kostante me alumni të diplomuar më parë në akademi, si dhe kompani punëdhënëse të teknikëve dentarë brenda dhe jashtë vendit. (A12, A48, A34, A47, A100)</p>




<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se konstatuam se në baze të raporteve të NJSBC, jepeshin rekomandimet për nxitjen e praktikave të mira dhe përmirësimin e pikave të dobëta, në kë të mënyrë NJSBC asistonte departamentet përkatëse për implementimin apo përmirësimin e praktikave mësimore aktuale. NJSBC gjeneronte analiza të shoqëruara me të dhëna, të cilat shërbenin për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta që kishte institucioni, duke implementuar tregues të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor apo pasqyrimin e gjendjeve aktuale të arritjeve dhe mangësive. (A30, A17, A18, A48).</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni kishte njësinë NJSBC organizuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe aktet e institucionit, e cila merrej me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, pa nënvlerësuar këtu edhe rolin e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>




Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike departamentet komunikojnë me çdo pedagog për aspektet e mësimdhënies, vlerësimit, çështjeve administrative, veprimtarisë mësimore e shkencore, si dhe trajnimeve të stafit. Po ashtu çdo vit, bazuar në planet vjetore, akademia kryente analizën e përgjithshme, ku një zë të rëndësishëm zinte vlerësimi i performancës së studimit mbi bazën e raportit të hartuar mbi gjendjen e programit të studimit, cilësisë, stafit akademik të rekrutuar, literaturës së re në bibliotekë, rezultateve të studentëve, kalueshmërisë dhe notës mesatare, marrëveshjeve të bashkëpunimit, veprimtarisë kërkimore shkencore, paraqitje në fund analiza SËOT si dhe masat e marra për përmirësimin e mangësive në të ardhmen. Duke patur parasysh specifikën që ka fusha e teknikëve dentarë, propozimet dhe përmirësimet ndërthureshin me kërkesat e tregut.</p> <p>(A15, A16)</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>NJSBC monitoronte në mënyrë të vazhdueshme mënyrën se si afrohej programi i studimit dhe përputhjen me standartet e cilësisë. Për përmirësimin e programit, institucioni dhe pedagogët t'ishin në kontakt të vazhdueshëm me studentët. Në disa raste propozimet e studentëve, që lidheshin me ngarkesën, oraret, veprimtaritë e ndryshme, diskutoheshin dhe ndryshoheshin sipas situatës.</p> <p>(A34, B13, B14).</p>



<p>Kriteri 3.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstytucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>NJSBC në organikën e saj kishte persona me karrierë akademike dhe eksperiencë që plotësonin standartet e cilësisë në arsimin e lartë. NJSBC ishte e angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e programit mësimor dhe arrinte të mblidhte të dhëna konkrete për ecurinë dhe cilësinë e tij (B14). AI siguronte implementimin e rasteve të pacientëve realë, që laboratorët bashkëpunorë i sillnin pedagogëve gjatë orëve të praktikave mësimore. Studentet praktikoheshin gjatë këtyre seksioneve në punë, të cilat realizoheshin shpesh në këtë institucion (B1).</p>		
<p>Kriteri 4.Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>NJSBC duke ndjekur dhe praktikat më të mira të kompanive leader, kishte studiuar dhe përshtatur sondazhe për stafin akademik dhe administrativ (A116). Me alumni dhe bashkëpunorët e tjerë, AI dhe NJSBC, në programin MP në TDD, ndërtonte pyetësorë dhe sondazhe, me synim vlerësimin e kënaqësisë, cilësisë për të fituar njohuri gjatë periudhës së studimit, përshtatur kjo me nevojat e tregut, si dhe informacione për lëndë të tjera interdisiplinore përbërëse të këtij programi.</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni realizonte evidentimin e arritjeve dhe dobësive, si dhe planin e masave për përmirësimet e mëtejshme. Në kuadër të vlerësimit dhe mbarëvajtjes së programit të studimit, institucioni përdorte sondazhe, intervista të studentëve, studentëve të diplomuar, personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe palëve të tjera që përfshiheshin në realizimin e këtij programi. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>		
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>




Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Strukturat drejtuese si rektorati, fakulteti dhe departamentet planifikonin, organizonin dhe zbatonin politikat dhe procedurat për realizimin e sigurimit të saj. Standartet dhe sigurimi i cilësisë së institucionit realizoheshin në përputhje me manualin e sigurimit të brendshëm dhe kodin e cilësisë së arsimit të lartë. Këto siguroheshin dhe nga organet brenda institucionit si dhe këshillimi me specialistë të fushës brenda dhe jashtë tij. (A68, A97, A117).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Zyra e NJSBC përbëhej nga drejtuesja e zyrës, 4 anëtarë të personelit akademik dhe një përfaqësues i studentëve, dhe ishin përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej stafit të zyrës. GVJ vlë rë soi se anëtarët e NJSBC ishin staf me eksperiencë akademike, me integritet dhe përfaqësues nga i gjithë personeli akademik dhe studentor (A97).</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Metodat e vlerësimit dhe rivlerësimit të cilësisë bazoheshin në përdorimin e treguesve të performancës, rishikimin vetërregullator, anketimin e studentëve, të diplomuarve/alumni, si dhe punonjësve, analizën e informacionit statistikor, krahasimin me praktikën më të mirë. Mekanizmat kryesore të matjes për vetëvlerësimin bazoheshin në të dhënat e mbledhura nga mekanizmat e grupit të vlerësimit, puna në ekip, rishikuesit vetërregullator, grupet e interesit, intervistat individuale, etj. Gjithashtu reflektoheshin të dhënat statistikore në njësitë përbërëse të akademisë ishin: regjistrimi i studentëve brenda kohëzgjatjes normale të studimit, numri i stafit akademik, alokimi i buxhetit dhe elementë të tjerë të ngjashëm dhe jepeshin rezultate dhe të dhëna dokumentuese, si teza provimesh, përgjigje përkatëse, publikime, vëzhgime të procesit mësimor, që disponoheshin nga titullarët e njësive përkatëse. (A97, A34, A47)</p>


<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>NJSBC, duke patur përfaqesues nga i gjithë personeli akademik, administrativ dhe studentor, garantonte integritetin akademik dhe shmangte çdo lloj diskriminimi. (A97, A63).</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni kishte si pjesë aktive të proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë edhe ekspertë të jashtëm që kishin lidhje me programin e studimit. NJSBC monitoronte edhe hartimi, miratimi dhe rishikimi i kurrikulave që ofronte AI, të cilat bëheshin në nivel fakulteti dhe departamenti. Për hartimin, miratimin dhe rishikimin e këtij programi studimi, përveç stafit akademik të njësisë përgjegjëse, rekomandohej për të patur partnerë me institucione me marrëveshje bashkëpunimi, ekspertë të jashtëm, shoqata dhe urdhëra përkatës profesionale, si dhe studentë aktuale të viteve të lart apo të ë diplomuar nga programi. Ekzistonin gjithashtu arrëveshje me Institute for Quality in Education, të cilë t funksiononin si ekspertë të jashtëm për vlerësimin e cilësisë me metodat e tyre të analizës së saj. NJSBC merr raportin e prej tyre dhe e diskuton me grupet e interesit (A13, A46)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Institucioni ishte përcaktuar përgjegjësitë përkatëse dhe detyrat e secilës njësi, individëve, studentëve dhe palëve të tjera të angazhuara në sigurimin e cilësisë, duke garantuar ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X



Standardi VI.5


Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Një nga format më të përdorura për kontrollin e cilësisë ishte pyetori për studentët, që organizohej dy herë në vit për gjithë programet, lëndët dhe pedagogët. Këto pyetorë i viheshin në dispozicion institucionit, dhe në varesi të vërejtjeve përkatëse merreshin masa për ndryshime strukturore. Në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë, organizimi dhe veprimtaritë e AI ishin publike dhe lehtësisht të konsultueshme online. (A30, A34, A47, A48, A50).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>NJSBC informonte rektorin, dekanin dhe shefin e departamentit, për rezultatet që dilnin nga anketimet e drejtpërdrejta me studentët, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive bazë dhe individëve në të ardhmen, sidomos kjo për rindërtimin e programit master. Rezultatet e përfituara nga monitorimet dhe vlerësimet e bëra bëheshin publike, për stafin, studentët, administratën, si në rastin e akreditimit institucional apo programit të studimit (A1, A97). Rezultatet e vlerësimit të NJSBC në lidhje me pedagogët i komunikoheshin atyre personalisht, si dhe viheshin në dijeni drejtuesit e departamenteve. Rezultatet e përgjithshme bëheshin publike në formë anonime. (B15, A26).</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Për secilin nga proceset akademike që ishin vlerësuar gjatë vitit, rezultatet raportoheshin pranë rektorit, dekanit dhe departamenteve, liheshin detyra dhe ndiqeshin nga NJSBC, e cila udhëzonte njësitë bazë dhe ato kryesore lidhur me pikat e forta dhe dobësitë e tyre, si dhe jepte sugjerime për të përmirësuar veprimtaritë e tyre (A30).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>MP në TDD përbënte një përditësim dhe aftësim shtesë të profesionistëve të tregut të shëndetit oral. AI tentonte përmes këtij programi studimi të përshtaste tregun vendas me zhvillimet e reja, sipas teknologjisë së informacionit në sektorin e shëndetit dentar. NJSBC vlerësonte në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe mbetej në kontakt me laboratorët partnerë që aktualisht përfaqësonin aktorët kryesorë të tregut të punës në sektorin e teknikave digjitale dentare, dhe hartonin raportet e analizës së brendshme. Një pjesë e analizës paraqitej në raportin vjetor të dërguar MAS, sipas formatit të kerkuar prej tyre (A17, A18), të cilat diskutoheshin në të gjithë njësitë e akademisë, me synim përmirësimin në të ardhmen, pa nënvlersuar vërejtjet e bëra nga MAS (A119).</p>



<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, përmirësimin e metodikës së tyre të mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të akademisë. Institucioni kishte strategji për përmirësim në vazhdimësi të cilësisë (A2), dhe përpiqej të përcillte tek personeli dhe studentët ndjenjën e cilësisë e cila konsiderohej e nevojshme dhe të shndërrohej në një kulturë institucionale, veçanërisht kjo në pedagogët e rinj. Ndikim të drejtpërdrejtë në sigurimin e cilësisë jepnin edhe takimet e drejtuesve me studentët, vlerësimi i mendimit të këshillit studentor për çdo lëndë apo pedagogu në veçanti (A63, A97, A109).</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>Në institucion sigurimi i brendshëm i cilësisë ishte transparent dhe bëhej publik për studentët apo personat e interesuar duke synuar vlerësimin dhe përmirësimin e mangësive apo dobësive të evidentuara në të ardhmen. <i>Për këtë arsye, GVJ mendon se ky standard përbushet plotësisht.</i></p>								
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="595 819 810 913">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="818 819 1010 913">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1018 819 1225 913">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1233 819 1431 913">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="595 913 810 969"></td> <td data-bbox="818 913 1010 969"></td> <td data-bbox="1018 913 1225 969"></td> <td data-bbox="1233 913 1431 969" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<p>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës VI</p>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional “Teknika digjitale Dentare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Akademia Ivodont.”

Pikat e forta dhe afirmime:


1. Ky program, duke qenë se është i vetëm në vend dhe aplikohet për herë të parë në dentistri, siguron aplikimin e protokolleve bashkëkohore digjitale të punës në klinikë dhe laborator dentar, në shërbime më të shpejta dhe më cilësore për pacientin.
2. Programi ofrohet në përputhje me misionin, strategjinë e zhvillimit të AI, kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij falë bashkëpunimit me prodhuesit më të mirë të teknologjisë digjitale dentare.
3. Programi pasqyron një gërshetim të mirë të njohurive teorike dhe praktike, me objektivin për të orientuar sa më mirë studentët drejt tregut dinamik të punës në një shoqëri globale, pa nënvlerësuar këtu turizmin dentar.

Pika të dobëta:

1. Numri i ulët i studentëve në këtë program studimi. [Standardi IV.5/Kriteri 5]
2. Staf i akademik duhet të punojë më shumë lidhur me kërkimin shkencor dhe ngritjen e nivelit të tyre akademik. [Standardi IV.1/Kriteri 1]

Rekomandime:

1. Të rritet numri i studentëve në të ardhmen.
2. Të shihet mundësia e unifikimit të ambjenteve të institucionit në një godinë të vetme.
3. Të rritet numri i bashkëpunimeve me klinika dhe laboratorë përsa i përket praktikës lidhur me pacientë realë.



Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master "Digital Dental Techniques" provided by the Higher Education Institution "Ivodont Academy"

Strengths and affirmations:


1. This program, being the only one in the country and applied for the first time in dentistry, ensures the application of contemporary digital work protocols in the dental clinic and laboratory, in faster and better services for the patient.
2. The program is offered in accordance with the mission, the AI development strategy, its academic and infrastructural capacities thanks to the cooperation with the best manufacturers of digital dental technology.
3. The program reflected a good interweaving of additional and practical knowledge, with the objective to better orient students towards the dynamic labor market in a global society, without underestimating dental tourism.

Weaknesses:

1. The number of students in this study program is reduced. [Standard IV.5/Criterion 1]
2. The academic staff should work more in relation to scientific research and raising their academic level. [Standard IV.1/Criterion 5]

Recommendations:

1. To increase the number of students in the future.
2. To see the possibility of unifying the areas of the institution in a single building.
3. To increase the number of collaborations with clinics and laboratories in terms of practice related to real patients.



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I.OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II.ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III.MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV.BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTUA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V.STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI.SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

